



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 4/2022 regjistër (JR)
Datë 24.01.2022

Nr. 41 i vendimit
Datë 31.10.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|------------------------|------------------|
| Ina Rama | Kryesuese |
| Mimoza Tasi | Relatore |
| Albana Shtylla | Anëtare |
| Rezarta Schuetz | Anëtare |
| Sokol Çomo | Anëtar |

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 31.10.2022, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 4/2022 (JR), datë 24.01.2022, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 476, datë 16.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative

dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 476, datë 16.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet përkatëse ndihmëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”) në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.
4. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, ka dërguar në Komision një raport në të cilin ka konstatuar se *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklaram të rremë; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Eda Kaja, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë në përfundim të procesit, vendimin nr. 476, datë 16.11.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni, me vendimin nr. 476, datë 16.11.2021, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës*, bazuar në konkluzionet për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja:
 - ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë;
 - ka kryer deklaram të rremë të pasurisë dhe veprime fiktive;
 - ka zhvilluar procese gjyqësore në situatë konflikti interesi;
 - nga analiza financiare, rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi i saj dhe personat e lidhur me të, nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara, në shumën -8.086.347 lekë.

III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) kundër vendimit nr. 476, datë 16.11.2021, të Komisionit, duke pretenduar se vendimi është i pabazuar, i paragjykuar dhe i paracaktuar, si dhe është rezultat i cenimit të parimeve të një procesi të rregullt ligjor dhe i mungesës së aplikimit të parimit të proporcionalitetit.
8. Shkaqet e ankimit lidhur me procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

8.1. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë argumentet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të barrës së provës, duke mos iu nënshtruar debatit gjyqësor dhe pa dhënë asnjë shpjegim mbi shkaqet për të cilat nuk janë vlerësuar provat dhe cila ishte vlera provuese e tyre.

8.2. Vendimi i Komisionit është tërësisht i paarsyetuar, përmban vetëm parashtrimet e hetimit dhe një pjesë të cunguar të parashtrimeve të paraqitura nga subjekti, ndërkohë që arsytimi i vendimit përmban vetëm tri fjali.

8.3. Vendimi përfundimtar u shpall në seancë dëgjimore pa u caktuar seancë për shpallje dhe pa u tërhequr trupa për marrjen e këtij vendimi, në shkelje të parimit të gjyqimit nga një gjykatë e

pavarur dhe e paanshme, dhe duke vënë në dyshim ekzistencën e një vendimi të paragjykuar dhe të paracaktuar.

9. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si në vijim.

9.1. Lidhur me të ardhurat nga shitja e një shtëpie në emër të bashkëshortit, vjehrrës dhe kunatit në shumën 4.000.000 lekë:

a) Shitja e kësaj pasurie është deklaruar në DPV-në e vitit 2005, në shumën totale prej 4.000.000 lekësh, sipas kontratës së shitblerjes së lidhur më datë 12.11.2004. Të ardhurat nga kjo shitje janë deklaruar dhe në deklaratën e pasurisë “vetting”. Ekzistojnë transaksione bankare që provojnë shitjen e kësaj pasurie dhe shuma e përfituar nuk mund të konsiderohet gjendje *cash* në banesë.

b) Lidhur me kontratën e depozituar në regjistrat publikë, e cila, sipas subjektit, rezulton fotokopje dhe jo dokument autentik, subjekti deklaron se nuk ka asnjë lloj dijenie për ekzistencën e një kontrate me çmim të ndryshëm nga kontrata autentike, dhe se nuk ka pasur asnjë dijeni për procedurat e regjistrimit të kësaj kontrate, jo vetëm sepse nuk ka qenë palë në atë kontratë, por edhe sepse këto procedura zakonisht ndiqen nga noteri.

9.2. Lidhur me pasurinë apartament, me sip. 115,9 m², me adresë në ish-rrugën “{*}”:**

a) Pasaktësitë në sipërfaqe në deklarimin e vitit 2005, kanë ardhur për shkak se apartamenti nuk ishte regjistruar si planimetri më vete dhe nuk ishin përcaktuar sipërfaqet e apartamenteve apo njësive që do të përfitoheshin në mënyrë përfundimtare.

b) Lidhur me vlerësimin e Komisionit se pasuritë nuk janë deklaruar në deklaratën e vitit 2009, ky konkluzion nuk është i vërtetë, pasi sipërfaqet e përfituara në bazë të kontratës së shkëmbimit, janë deklaruar pranë ILDKPKI-së në vitin 2010, kur subjekti është thirrur për të dhënë sqarime mbi kontrollin e saktësisë së deklarimeve periodike. Gjithashtu, në deklaratën *vetting* janë pasqyruar saktësisht pasuritë dhe sipërfaqet e tyre, sipas dokumenteve hipotekore, mbi bazën e të cilave janë regjistruar këto pasuri.

c) Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se ka bërë deklaram të pasaktë të vlerës së investimit në deklaratat periodike dhe në deklaratën *vetting*, si dhe se ka pasur mungesë burimesh të ligjshme për pagesën e shumës 20.000 euro, subjekti pretendon se ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e blerjes së apartamentit, shpenzimet e arredimit dhe shlyerjen e kësteve të kredisë bankare.

ç) Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se ekzistenca e dy kontratave të ndryshme për shitjen e njësive së shërbimit, është bërë me qëllim shmangien e pagesës së detyrimeve tatimore, subjekti parashtron se shumën nga shitja e njësive së ka përfituar të gjithën, në vlerë të plotë prej

23.000 eurosh, nga kontrata e premtimshitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.11.2008. Kontrata e shitblerjes e vitit 2012 nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike apo financiare për subjektin, por vetëm për bashkëpronaren tjetër të njësisë, e cila nuk e kishte përfituar ende shumën e kësteve të mbetura nga blerësi. Dyshimi i Komisionit për kontratë fiktive për shmangien e tatimit mbetet i paprovuar me asnjë provë apo indicie konkrete, pasi subjekti e ka paguar detyrimin që i takonte, përndryshe nuk do të mund të realizohej transaksioni në hipotekë.

d) Lidhur me konkluzionin e Komisionit për kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin P. Ll., subjekti parashtron se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie personale me këtë shtetas, dhe se marrëdhënia juridike për ndërtim në truallin e trashëguar ka qenë me shoqërinë "{***}" ShPK, pavarësisht se kush ka qenë ortak apo administrator i saj. Subjekti sqaron se vendimi i dhënë prej tij nuk ka shqyrtuar në themel çështjen, por vetëm vendimmarrjen e organit të prokurorisë për mosfillim procedimi. Gjithashtu, subjekti thekson se rastet e heqjes dorë të gjyqtarit nuk bazohen në ligjin nr. 9367 "Për parandalimin e konfliktit të interesave", por në Kodin e Procedurës Penale.

9.3. *Lidhur me kredinë bankare marrë pranë NBG Bank Durrës për blerjen e një apartamenti të përbashkët, të regjistruar në emër të bashkëshortit:*

9.3.1. Subjekti i rivlerësimit shprehet në ankim se nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni argumentet e parashtruara në lidhje me kontratën e premtimshitjes së njësisë së shërbimit. Komisioni ka konkluduar se edhe pas prapësimeve dhe shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës për mungesën e burimeve të ligjshme për shlyerjen e kredisë, sepse të ardhurat e përfituara nga shitja e dyqanit në shumën 23.000 euro, në analizën financiare janë llogaritur në shumën 0 (zero) lekë, pasi për këtë shumë nuk është paguar tatim – konfirmuar nga subjekti. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për shlyerjen e kredisë në shumën 2.834.520 lekë.

9.4. *Lidhur me apartamentin e regjistruar në emër të bashkëshortit, me sipërfaqe 55 m², me adresë lagjja {***}, {***}, Durrës:*

9.4.1. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet dhe mobilimin e apartamentit, pasi nuk ka marrë në konsideratë:

- gjendjen e likuiditeteve në fillim të vitit 2008, të cilat janë të mbartura që nga viti 2003;
- të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit, të pasqyruara në dokumentacionet e tatimeve;
- të ardhurat e përfituara nga shitja e dyqanit në shumën 23.000 euro, të cilat kanë qenë si burim për shlyerjen e kredisë bankare në shumën 25.000 euro;
- vlera e apartamentit, pa përfshirë arredimin, është në vlerën 3.690.000 lekë dhe diferenca përbën shpenzimet për arredim të cilat nuk janë kryer të gjitha në vitin 2008.

9.5. *Lidhur me të ardhurat nga shitja e aksioneve të kantinës së pijeve "{***}", në emrin e subjektit dhe të bashkëshortit:*

9.5.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit, pasi, ndryshe nga sa shprehet Komisioni, aksionet janë deklaruar pranë ILDKPKI-së sipas procesverbalit të vitit 2010, si dhe janë deklaruar në deklaratën *vetting*, në rubrikën "Angazhime dhe veprimtari", ku janë cilësuar si të ardhura të bashkëshortit, punonjës i kantinës (paga + aksione) nga muaji janar 1994 - prill 2002.

9.5.2. Me privatizimin e kantinës, subjekti dhe bashkëshorti kanë përfituar 100 aksione, me kuotë pjesëmarrjeje, secili 0,015. Si aksionarë të shoqërisë, subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur funksione në organe drejtuese apo ekzekutive të shoqërisë, nuk kanë përfituar dividend apo ndonjë përfitim tjetër nga këto aksione. Vetëm fakti i tjetërsimit të aksioneve pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, tregon sjelljen e subjektit për të shmangur mundësitë e lindjes së një konflikti interesi.

9.6. *Lidhur me automjetet në emër të bashkëshortit të subjektit:*

9.6.1. Subjekti parashtron në ankim se automjeti me targë {***}, është blerë në vitin 2009, në shumën 5.000 euro, me të ardhura të realizuara nga shitja e makinës së mëparshme me targë {***}. Shumën e përfituar nga shitja e automjetit me targë {***}, subjekti pretendon se bashkëshorti e ka marrë para se të finalizohet kontrata e shitjes, dhe për këtë ka paraqitur si provë para Komisionit deklaratën noteriale të blerësit K. A.. Ndërsa burim për blerjen e automjetit me targë {***}, janë të ardhurat vjetore për vitin 2004. Mosdeklarimi i blerjes së automjetit në vitin 2004, nuk është bërë për shkak se diferenca në çmim me automjetin e mëparshëm, të deklaruar në vitin 2003, ishte shumë e vogël.

9.7. *Lidhur me të ardhurat në vlerën 10.002.316 lekë të bashkëshortit të subjektit si ortak i vetëm i shoqërisë "{***}" ShPK:*

9.7.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar konkluzionin e Komisionit se të ardhurat e shoqërisë "{***}" ShPK, për periudhën 3.7.2006 - 21.12.2009, për shkak të mosshpërndarjes së dividendit dhe pagimit të tatimit përkatës, nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme. Subjekti parashtron se sipas ligjit të kohës, shoqëria nuk ka pasur detyrim për të paguar tatim mbi dividendin, si biznes i vogël, dhe në këto kushte, e ardhura neto pas pagimit të tatimit mbi fitimin, ka qenë më e madhe.

9.8. *Lidhur me blerjen e automjetit të personit të lidhur, djalit A.K.:*

9.8.1. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e djalit për vitin 2012 dhe janar 2013, nga punësimi pranë shoqërisë "{***}". Komisioni, përveçse nuk i ka përfshirë këto të ardhura në tabelën e analizës financiare, nuk i ka marrë në konsideratë as si kursime për blerjen e automjetit.

9.8.2. Subjekti i rivlerësimit ka ankimuar analizën financiare totale të vitit 2014, duke konkluduar se ka rezultuar me diferencë pozitive, pra se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit në qershor të vitit 2014, në kushtet kur në të njëjtën periudhë ka shitur automjetin tjetër në të njëjtën vlerë, po kështu dhe për kryerjen e të gjitha shpenzimeve.

9.9. *Lidhur me huatë e marra, në shumat 10.000 euro në vitin 2005 dhe 10.000 euro në vitin 2006, nga shtetasi D. H.:*

9.9.1. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke parashtruar se aplikimi i nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me këtë marrëdhënie, nuk duhet të përlloraget për të gjithë shumën e marrë hua, për sa kohë që shuma e marrë nuk ka shërbyer për shtimin apo krijimin e ndonjë pasurie për subjektin apo për përballimin e ndonjë shpenzimi. Lidhur me pasaktësitë në deklaratat vjetore, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se gabimet apo harresat duhet të përfshihen në një gabim njerëzor që nuk ka të bëjë me asnjë aspekt të fshehjes apo deklarimit të rremë ose të pasaktë, si një deklaram të pamjaftueshëm të tillë që cenon standardet e nenit D të Kushtetutës dhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

9.10. Subjekti i rivlerësimit ankimon analizën financiare totale të viteve 2003, 2005, 2006, 2009 dhe 2014, duke parashtruar disa kërkesa lidhur me elementet në analizën financiare të këtyre viteve, për sa i përket llogaritjes së gjendjes *cash* dhe të disa të ardhurave dhe shpenzimeve.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Aspekte procedurale

a) Mbi juridiksionin e Kolegjit

- 10.** Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.
- 11.** Nga verifikimet e kryera në fashikullin e çështjes objekt gjykimi, rezulton se ankimi i subjektit të rivlerësimit është përcjellë në Kolegj i shoqëruar me vendimin e Komisionit nr. 476/1, datë 11.01.2022 “Për pranimin e ankimit”, me aktet e komunikimit të ankimit subjekteve të procesit, si dhe me dosjen e krijuar gjatë procesit të rivlerësimit në Komision. Ky ankim është regjistruar në

Kolegj, me nr. 4/2022 (JR), datë 24.01.2022, në përputhje me rregulloren e veprimtarisë së Kolegjit, dhe shqyrtimi në vijim është sipas parashikimeve të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Mbi legjitimitimin e ankuesit

12. Ankuesja Eda Kaja, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka ushtruar funksionin e gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe, në zbatim të nenit F, pika 2 e Kushtetutës, legjitimohet *ratione personae* për të ankimuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
13. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Eda Kaja, është shpallur në seancë publike më datë 16.11.2021. Vendimi i arsyetuar nr. 476, datë 16.11.2021, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***}, datë 24.12.2021, të Komisionit, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni më datë 27.12.2021. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë pranë Komisionit ankimin e tij kundër vendimit të Komisionit nr. 476, datë 16.11.2021, protokolluar pranë Komisionit me nr. {***} prot., datë 07.01.2022. Bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit dhe subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione temporis*.

c) Mbi formën e gjykimit të ankimit

14. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur ndaj vendimit të Komisionit ushtrohet ankim nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.
15. Në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të pretendimeve të paraqitura në ankim, si dhe në parashtrimet shtesë të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “Kolegji”) nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në Kolegj për korrigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, dhe vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit

16. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë argumentet dhe provat e paraqitura në kuadër të barrës së provës, duke mos iu nënshtruar debatit

gjqësor dhe pa dhënë asnjë shpjegim mbi shkaqet për të cilat nuk janë vlerësuar provat dhe cila ishte vlera provuese e tyre, Kolegji analizon si vijon.

16.1. Referuar akteve të administruara në fashikuj, rezulton se Komisioni, në përgjigjen drejtuar kërkesës së subjektit për njohjen me rezultatet e hetimit për të tria kriteret, e ka njoftuar me *e-mail*-in e datës 08.11.2021, se pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën për njohjen me rezultatet e hetimit administrativ lidhur me kriterin e figurës dhe atë profesional, si dhe përfundimin e procesit të rivlerësimit bazuar në të tria kriteret, pas seancës dëgjimore dhe para marrjes së vendimit përfundimtar, do të vlerësonte të gjitha provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti para dhe gjatë seancës, dhe nëse ato do të vlerësoheshin bindëse dhe të mjaftueshme për rihapjen e hetimit, trupi gjykues do të procedonte me marrjen e vendimit përkatës për rihapjen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera, atë të figurës dhe të aftësive profesionale.

16.2. Gjatë seancës dëgjimore të datës 11.11.2021, subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesja ligjore e tij kanë parashtruar pretendimet sa u përket gjetjeve të hetimit, çdo shpjegim tjetër që kanë çmuar të nevojshëm, si dhe u janë përgjigjur pyetjeve dhe sqarimeve të kërkuara nga trupi gjykues.

16.3. Në vendimin e Komisionit janë pasqyruar të gjitha provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me prapësimet për rezultatet e hetimit, si dhe është kryer analizimi dhe vlerësimi i tyre në përputhje me përcaktimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sa i përket vlerës provuese të tyre në raport me provat dhe aktet e tjera të administruara gjatë hetimit, si dhe për ndikimin e tyre në konkluzionet dhe në analizën financiare të kryer nga Komisioni. Në vendimin nr. 476, datë 16.11.2021, Komisioni është shprehur se: *18. [...] Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite; c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI; d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike, private dhe individë; e) deklaratime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik.*

16.4. Nga sa më sipër, Kolegji çmon se subjektit i është garantuar e drejta për të paraqitur prova, se Komisioni ka kryer procesin e shqyrtimit dhe të vlerësimit të provave në të gjitha fazat e procesit të rivlerësimit, si dhe ka argumentuar vlerën e tyre provuese në vendimin përfundimtar. Për rrjedhojë, Kolegji i gjen të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim.

17. Subjekti ka parashtruar në ankim se vendimi i Komisionit është tërësisht i paarsyetuar, përmban vetëm parashtrimet e hetimit dhe një pjesë të cunguar të parashtrimeve të paraqitura nga subjekti, ndërkohë që arsyetimi i vendimit përmban vetëm tri fjali.

17.1. Lidhur me këtë shkak ankimi, Kolegji, pasi shqyrtoi vendimin objekt ankimi në raport me parashikimin e nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, konstatoi se vendimi i Komisionit përmban përshkrimin e rrethanave të çështjes, të provave të sjella nga subjekti i rivlerësimit dhe të akteve të marra nga Komisioni gjatë procesit të hetimit, analizën e provave të administruara, si dhe

përfundimet e nxjerra lidhur me to nga trupi gjykues i Komisionit. Për secilën pasuri apo të ardhur të hetuar, në vendim janë pasqyruar dhe vlerësuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet mbi të cilat është mbështetur, duke i cituar ato herë pas here.

17.2. Vendimi i Komisionit rezulton të ketë mjaftueshëm argumentim e arsyetim për të shpjeguar qëndrimet e marra nga trupi gjykues dhe, në këtë mënyrë, ai është në përputhje edhe me kriteret e vendosura prej jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe të GjEDNj-së, lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Kjo e fundit, në çështjen *Van de Hurk kundër Holandës* ka mbajtur qëndrimin se: *Neni 6 i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument.* Për sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se arsyetimi i vendimit nr. 476, datë 16.11.2021, të Komisionit është i plotë, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, dhe se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara.

- 18.** Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankimi se vendimi përfundimtar u shpall nga Komisioni në seancë dëgjimore pa u caktuar seancë për shpallje dhe pa u tërhequr trupa për marrjen e këtij vendimi, në shkelje të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si dhe duke vënë në dyshim ekzistencën e një vendimi të paragykuar dhe të paracaktuar.

18.1. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, Kolegji, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi se në procesverbalin e seancës dëgjimore të datës 11.11.2021, në mbyllje të seancës, pasi është ftuar dhe është dëgjuar subjekti i rivlerësimit për qëndrimin përfundimtar, kryesuesja e trupit gjykues ka deklaruar se: *Në vijim, trupa gjyqësore do të vlerësojë shpjegimet e dhëna në këtë seancë dëgjimore, rezultatet e hetimit të dërguara nëpërmjet postës elektronike dhe gjithë provat e dorëzuara sot. Trupi gjykues tërhiqet për vendim, kjo seancë do të rifillojë në datën 16.11.2021, në orën 9:30, në këtë sallë.* Pra, subjekti pjesëmarrës në këtë seancë ka qenë i njohur me faktin se trupa po tërhiqej për vendim dhe se seanca e radhës, për shpalljen e vendimit, do të ishte më datë 16 nëntor 2021. Për sa më sipër, rezulton se Komisioni ka kryer veprimet e duhura procedurale për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe shpalljen e vendimit, sipas parashikimeve të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë nen, në pikën 6 parashikohet se: *Vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore, dhe këtë parashikim ka pasur parasysh Komisioni në njoftimin që seanca do të rifillonte në datën 16.11.2021.*

18.2. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, për dyshime për ekzistencën e një vendimi të paragykuar dhe të paracaktuar, Kolegji çmon se ky pretendim mbetet në nivel deklarativ, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë provë që mbështet këtë pretendim të saj.

18.3. Në përfundim të sa më sipër, Kolegji e gjen të pabazuar në fakte dhe në ligj këtë shkak ankimi të subjektit të rivlerësimit.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

i.) Lidhur me të ardhurat nga shitja e një shtëpie në emër të bashkëshortit, vjehrrës dhe kunatit në shumën 4.000.000 lekë, të përdorura për punime dhe arredimin e apartamentit të banimit të vitit 2005:

19. Nga aktet e administruara në Komision, rezulton se në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Të ardhura nga shitja e një shtëpie në emër të bashkëshortit, të vjehrrës dhe kunatit [...]. Këto të ardhura janë përdorur për punime dhe arredimin e shtëpisë, ku aktualisht jetojmë prej vitit 2005. Shuma e deklaruar 4.000.000 lekë.*
20. Komisioni për këto të ardhura ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me shumën e përfituar prej 4.000.000 lekësh, në deklaratën e interesave privatë periodikë (në vijim "DIPP"), në kundërshtim me pikën 5/a të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime fiktive me depozitim në Komision të kontratës së shitjes me vlerë 4.000.000 lekë, ndërkohë që në ASHK rezulton e depozituar kontrata e shitjes me të njëjtat ekstremite, me vlerë 2.000.000 lekë, me qëllim shmangien e pagimit të tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga vlera reale e shitjes. Subjekti ka bërë deklaram të rremë në paraqitjen e të dhënave joreale të kontratave dhe deklarimeve përpara Komisionit.
21. Lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, subjekti i rivlerësimit në ankimin drejtuar Kolegjit, parashtron se shitja e kësaj pasurie është deklaruar në DIPP-në e vitit 2005, në shumën totale prej 4.000.000 lekësh, sipas kontratës së shitblerjes së lidhur më datë 12.11.2004. Të ardhurat nga kjo shitje janë deklaruar dhe në deklaratën *vetting*. Subjekti pretendon se ekzistojnë transaksione bankare që provojnë shitjen e kësaj pasurie, dhe shuma e përfituar nuk mund të konsiderohet gjendje *cash*, por gjendje e likuiditeteve që bashkëshorti ka mbartur prej këtij veprimi juridik.
22. Subjekti i rivlerësimit parashtron se nuk ka asnjë lloj dijenie për ekzistencën e një kontrate me çmim të ndryshëm nga kontrata autentike, dhe se nuk ka pasur asnjë dijeni për procedurat e regjistrimit të kësaj kontrate, jo vetëm sepse nuk ka qenë palë në atë kontratë, por edhe sepse këto procedura zakonisht ndiqen nga noteri.
23. Kolegji, në funksion të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, verifikoi përmbajtjen e akteve të administruara përgjatë hetimit administrativ, nga të cilat rezultojnë faktet e mëposhtme.
 - 23.1. Subjekti i rivlerësimit shitjen e këtij apartamenti e ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2005, duke deklaruar se është shitur kjo pasuri për vlerën 4.000.000 lekë, me pjesën takuese prej 50%. Në rubrikën "Dhurata dhe trajtime preferenciale", subjekti ka deklaruar gjithashtu se: *Pjesën e lekëve të shtëpisë, vjehrra dhe kunati na i kanë dhuruar ne, pasi në atë shtëpi kemi banuar ne.*
 - 23.2. Subjekti i rivlerësimit, bashkë me deklaratën *vetting*, ka depozituar kontratën e shitblerjes me nr. {***}, datë 12.11.2004, me shitës shtetasit G. (me 4/6 pjesë), A. dhe E. K. (me 1/6 pjesë) që i shesin

apartamentin me sip. 78,09 m², në lagjen {***}, rruga “{***}”, Durrës, blerësit Xh. I., me çmimin 4.000.000 lekë, çmim i cili është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

23.3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës - Zyra Vendore Durrës, me shkresën nr. {***} prot., datë 8.1.2020, ka konfirmuar se apartamenti me sip. 78,9 m² ka qenë i regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve M., G., E. K. dhe Eda Kaja dhe, më pas, me kontratë dhurimi nga bashkëpronarët dhe Eda Kaja, ka kaluar në pronësi të shtetasve M. dhe G. K.. Pas ndarjes nga jeta të shtetasit M. K., vjehtëri i subjektit, kjo pasuri, në bazë të dëshmisë së trashëgimisë, ka kaluar në bashkëpronësi të shtetasve G., A. dhe E. K. dhe, më pas, me kontratë shitjeje, ka kaluar në pronësi të shtetasit Xh. I.

23.4. Lidhur me përfitimin e gjithë shumës prej 4.000.000 lekësh, pavarësisht pjesës takuese të bashkëshortit të saj, subjekti ka shpjeguar në Komision se nuk është formalizuar dhënia e kësaj shume nga vjehtëra dhe kunati me ndonjë kontratë dhurimi për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare. Në mbështetje të këtij shpjegimi, subjekti ka paraqitur në Komision bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, edhe deklaratën e datës 23.8.2021 në gjuhën italiane të noterizuar/përkthyer, në të cilën bashkëshortja e të ndjerit A. K. (kunati i znj. Eda Kaja) deklaroi se bashkëshorti i saj nuk ka marrë asnjë shumë nga shitja e apartamentit, edhe pse rezultonte trashëgimtar ligjor i z. M. K., dhe se të ardhurat nga shitja ia ka dhuruar vëllait E. K..

23.5. Në funksion të provimit të pagimit të detyrimeve tatimore që vijnë për shkak të shitjes së kësaj pasurie, subjekti ka paraqitur një shkresë kthim përgjigjeje të datës 18.8.2021, nga ASHK-ja Durrës, e cila konfirmon, nga verifikimet e bëra, se për aplikimin nr. {***}, datë 17.11.2004, për kalimin e pronësisë së kontratës nr. {***}, datë 12.11.2004, është paguar tatimi, por nuk konfirmon vlerën e apartamentit mbi të cilin është paguar tatimi.

23.6. Lidhur me verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga shitja e kësaj pasurie, Komisioni ka administruar praktikën e tjetërsimit të apartamentit me sip. 78,9 m² nga ASHK-ja, nga e cila rezultoi e depozituar kontrata e shitblerjes me nr. {***}, datë 12.11.2004, me shitës shtetasit G., A. dhe E. K. dhe blerës shtetasit Xh. I. për shitjen e apartamentit me sip. 78,09 m², të ndodhur në lagjen {***}, rruga “{***}”, Durrës, me çmimin 2.000.000 lekë, çmim i paguar jashtë zyrës noteriale. Në këtë kontratë parashikohet se pala shitëse është e detyruar të paguajë në ZRPP-në Durrës 0,5% të çmimit total të shitjes. Bashkëngjitur kësaj kontrate është depozituar edhe mandatarkëtimi nr. {***}, datë 17.11.2004, ku pasqyrohet se është arkëtuar nga shtetasja G. K., shuma 10.000 lekë me përshkrimin: “{***}”.

24. Në analizë të akteve sa më sipër referuar, Kolegji konstaton, ashtu si edhe Komisioni, se ekzistojnë dy kontrata shitblerjeje për apartamentin, kontrata e paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit, me nr. {***}, datë 12.11.2004, me shitës shtetasit G., A. dhe E. K. dhe blerës shtetasit Xh. I., për shitjen e apartamentit me sip. 78,09 m², i ndodhur në lagjen {***}, rruga “{***}”, Durrës, me çmimin 4.000.000 lekë, çmim i paguar jashtë zyrës noteriale, si dhe kontrata e depozituar në ASHK me nr. {***}, datë 12.11.2004, me shitës shtetasit G., A. dhe E. K. dhe blerës shtetasit Xh. I. për shitjen e apartamentit me sip. 78,09 m², të ndodhur në lagjen {***}, rruga “{***}”, Durrës, me çmimin 2.000.000 lekë, çmim i

paguar jashtë zyrës noteriale. Të dyja kontratat janë lidhur tek i njëjti noter, kanë të njëjtët numra repertori dhe koleksioni, të njëjtën datë e tekst dhe janë firmosur nga të njëjtat palë, me ndryshimin e vetëm të çmimit të shitjes.

25. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kontrata e vetme e ligjshme dhe që ka prodhuar pasoja juridike për blerësin dhe shitësin është ajo e administruar në dosjen e hetimit administrativ dhe që përputhet me transaksionet bankare që vërtetojnë kalimin e shumës 4.200.000 lekë në llogarinë e bashkëshortit, Kolegji konstaton se akti që ka prodhuar pasojat ligjore të dëshiruara, pra kalimin e pronësisë nga shitësit te blerësi, është kontrata e shitblerjes që është regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe mbi çmimin e së cilës është paguar edhe detyrimi tatimor që buron nga ligji nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”. Nga mandatarkëtimi nr. {***}, datë 17.11.2004, i depozituar në dosjen e ASHK-së, rezulton se shtetasja G. K., si një nga shitëset e apartamentit, ka paguar si tatim shumën 10.000 lekë, të llogaritur në mandat me përshkrimin: “{***}”, pra mbi vlerën 2.000.000 lekë. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se nga shuma prej 4.000.000 lekësh, e deklaruar se është përfituar prej subjektit nga shitja e kësaj pasurie, vetëm shuma prej 2.000.000 lekësh rezulton e deklaruar si e ardhur e fituar nga ky transaksion në organet tatimore dhe për të cilën janë paguar edhe detyrimet tatimore, për pasojë vetëm kjo shumë plotëson kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, për t’u konsideruar si e ardhur e ligjshme. Fakti se në llogarinë e bashkëshortit ka kaluar shuma prej 4.000.000 lekësh si e ardhur nga ky transaksion, nuk është i mjaftueshëm për të legalizuar këtë vlerë si një të ardhur të ligjshme në kuptim të dispozitave të mësipërme dhe të praktikës tashmë të konsoliduar të Kolegjit¹.
26. Përveç këtij konstatimi, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja, pavarësisht pretendimit se nuk ka qenë në dijeni të hartimit apo regjistrimit të një kontrate të ndryshme nga ajo që ka disponuar, nuk ka bërë asnjë përpjekje për të ndrequr këtë shkellje të ligjit, edhe sikur të jetë kryer pa dijeninë e saj, duke paguar detyrimet tatimore në momentin kur ajo është vënë në dijeni të situatës faktike për shkak të akteve që janë depozituar në Komision nga ASHK-ja. Subjekti rezulton se është sjellë ndryshe me detyrimin tatimor të pretenduar se duhej të paguhej për shkak të shitjeve të automjeteve me çmim më të lartë se blerja, siç do të arsyetohet në vijim, por ka pasur një qasje indiferente në lidhje me këtë pasuri, ndonëse situata e ekzistencës së dy kontratave ka qenë evidente. Në këto kushte, Kolegji, pavarësisht se vlera e kaluar në llogarinë bankare të bashkëshortit prej 4.000.000 lekësh është një e ardhur e krijuar nga shitja e apartamentit në fjalë, shumë e cila si e tillë duhej t’i nënshtrohej tatimit mbi të ardhurat sipas ligjit nr. 8438/1998, nuk gjen asnjë argument ligjor të legjitimojë në funksion të këtij procesi, të gjithë këtë shumë, pasi sjellja e subjektit nuk ka lënë vend as për aplikimin e qëndrimit orientues të Kolegjit në vendimin nr. 15/2021, lidhur me pagimin me vonesë të detyrimeve tatimore, duke qenë se nuk e ka shfrytëzuar mundësinë e shërimit të kësaj paligjshmërie që ka ardhur jo prej veprimeve të drejtpërdrejta të subjektit, por të familjarëve të saj e veçanërisht të personit të lidhur, bashkëshortit, i cili ka qenë nënshkrues i kontratës në të dyja versionet. Në këto kushte, Kolegji e gjen të drejtë qëndrimin e mbajtur prej Komisionit se e ardhur e ligjshme, e krijuar nga ky transaksion, do të duhet të konsiderohet vetëm

¹ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2019 (JR), paragrafi 21.12; nr. 23/2020 (JR), paragrafi 25.4; nr. 35/2021 (JR), paragrafi 18.6.

shuma prej 2.000.000 lekësh, e cila i është nënshtruar tatimit dhe si e tillë do të konsiderohet në analizën financiare që është bërë në drejtim të verifikimit të burimeve të subjektit për të financuar krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të tjera.

27. Në vijim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, se *shitja e kësaj pasurie dhe shuma e përfituar nuk mund të konsiderohet gjendje cash në banesë, por gjendje e likuiditeteve që bashkëshorti i saj ka mbartur prej këtij veprimi juridik*, në vlerësim të akteve në fashikujt e subjektit të rivlerësimit, Kolegji vëren se:

27.1. Pretendimi i subjektit lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, nuk duket relevant për zgjidhjen e çështjes. Komisioni ka bërë në analizën e tij në vendim edhe një arsyetim rreth mosdeklarimit të gjendjes *cash* prej subjektit në vitin 2004, të përfituar prej shitjes së kësaj pasurie, por, në vijim të po kësaj analize, Komisioni, duke arsyetuar mbi kohën e tërheqjes nga llogaria në Intesa SanPaolo Bank, të kësaj shume prej 4.000.000 lekësh, më datë 17.12.2004, e ka vlerësuar të besueshëm shpjegimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, se ajo e ka mbartur *cash* këtë shumë në vitin 2005, pavarësisht se nuk e ka deklaruar si të tillë në DIPP-në e vitit 2004, duke e njohur këtë pretendim. Pavarësisht kësaj, Komisioni ka llogaritur si të ardhur të ligjshme në analizën financiare për vitin 2004, vetëm vlerën prej 2.000.000 lekësh, për të cilën janë paguar detyrimet tatimore dhe, për shkak të këtij qëndrimi, ka rezultuar se subjekti ka qenë në pamundësi të justifikonte me burime të ligjshme shpenzimet e kryera për financimin e pasurisë apartament në Durrës, në vlerën prej (-) 473.000 lekësh. Për shkak të këtyre rrethanave dhe qëndrimit të mbajtur prej Kolegjit në çështjen e mësipërme, pretendimi i subjektit konsiderohet i paarsyeshëm dhe pa efekt në shqyrtimin e vendimit të Komisionit objekt gjykimi.

28. Në parashtrimet shtesë të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, për të *ardhurat nga shitja e apartamentit në Durrës në emër të bashkëshortit, të vjehrrës dhe kunatit, të përdorura për punimet dhe arredimin e apartamentit të banimit në rr. “{***}”, Durrës, 115,9 m²*, subjekti pretendon se Komisioni në analizën financiare të prezantuar me rezultatet e hetimit në vitin 2004, e ka përfshirë vlerën prej 4.200.000 lekësh të përfituar nga shitja e apartamentit në emër të vjehrrës dhe bashkëshortit, ndërsa në vendimin e Komisionit kjo vlerë nuk është marrë në konsideratë. Sipas subjektit, për këtë element të analizës financiare i cili ka ndikuar ndjeshëm në konkluzionin për kontrollin e pasurisë, nuk ka mundur të mbrohet në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk i është kaluar barra e provës.

28.1. Kolegji, pasi verifikoi këtë pretendim të subjektit duke analizuar përmbajtjen e rezultateve të hetimit të dërguara prej Komisionit në përfundim të hetimit administrativ, konstatoi se ky pretendim është i pabazuar në këto të dhëna që vijnë nga aktet e fashikullit të hetimit. Në raportin mbi hetimet paraprake, Komisioni ka konstatuar ekzistencën e dy kontratave të shitjes me vlera të ndryshme, si dhe vlerën e kaluar në llogarinë bankare të personit të lidhur si vlerë e ndryshme nga kontratat (prej 4.200.000 lekësh) dhe për këto gjetje i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë argumentet përkatëse, shoqëruar dhe me provat shkresore. Konstatohet se sipas

metodologjisë së kryerjes së analizës financiare, në pikën 1.4² dhe në pikën 1.8³, janë përfshirë në analizën paraprake të rezultateve hetimore, po ashtu dhe në tabelën e analizës në këtë aneks, në vitin 2004 – vlera 333.333 lekë (si 1/6 e vlerës 2.000.000 lekë të shitjes, për të cilën ishin paguar tatimet) dhe në vitin 2005 – vlera prej 1.666.667 lekësh, si dhurim nga vjehrra dhe kunati (5/6 e vlerës 2.000.000 lekë), pra në total vlera prej 2.000.000 lekësh. Po ashtu në vendim, në analizën e rishikuar pas përgjigjeve të rezultateve hetimore nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, në analizën e vitit 2004, ka konsideruar sërish vlerën prej 2.000.000 lekësh si të ardhur.

28.2. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se është i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka përfshirë në analizën e rezultateve hetimore vlerën e përfituar, prej 4.200.000 lekësh, si dhe se nuk i është kaluar barra e provës për këtë të ardhur, duke qenë se situata faktike rezulton të jetë e ndryshme dhe që Komisioni të ketë qartësuar në rezultatet e hetimit dhe t'i ketë kaluar barrën e provës subjektit lidhur me këtë shumë, në të njëjtën linjë me qëndrimin që ka mbajtur edhe në vendimin përfundimtar.

- 29.** Për sa i përket parashtrimit të subjektit të rivlerësimit se diferenca prej 200.000 lekësh, që është më tepër se kontrata e shitjes së kësaj pasurie, përfaqëson vlerën e orendive me të cilat ishte pajisur ky apartament dhe që i janë shitur shitësit së bashku me apartamentin, Kolegji vëren se ky pretendim ngrihet për herë të parë nga subjekti në parashtrimet shtesë, si dhe nuk provohet me asnjë nga aktet e depozituara në Komision. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se nuk mund të kontrollojë vendimin e Komisionit mbi pretendime të cilat nuk janë paraqitur asnjëherë para tij, megjithëse situata ka qenë krejtësisht e njohur për subjektin dhe, për pasojë, nuk e analizoi këtë pretendim të subjektit si të paraqitur tej afateve ligjore dhe të rënë në dekadencë në kuptim të nenit 459, pika 2 e Kodit të Procedurës Civile.
- 30.** Në mbështetje të konkluzionit se, si e ardhur e ligjshme nga shitja e apartamentit të familjes së bashkëshortit, do të konsiderohet vlera prej 2.000.000 lekësh, sipas analizës financiare të vitit 2004, të kryer në Kolegj, konfirmohet rezultati i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë rezultuar me një mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve për këtë vit, në vlerën prej (-) 1.746.922 lekësh.
- 31.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me autenticitetin e kontratës së shitblerjes të depozituar në ASHK, Kolegji vlerëson se kjo është një çështje e cila nuk mund të drejtohet në këtë fazë të procesit para Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndërsa subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja, ka pasur të gjithë mekanizmat ligjorë për të ushtruar të drejtat e saj në institucionet kompetente për adresimin e kësaj çështjeje, madje edhe para Komisionit që në fazën kur zyrtarisht është vënë në dijeni

² “1.4.Për të ardhurat nga shitja e shtëpisë së bashkëshortit, është marrë në analizë vlera 333.333 lekë nga pjesa takuese(1/6) e tij për çmimin mbi të cilin është paguar tatim (2.000.000 lekë).”

³ “1.8. Për të ardhurat nga dhurimi i pjesës takuese të shtëpisë bashkëshortit, është marrë në analizë në vitin 2005, vlera 1.666.666 lekë nga pjesa takuese (5/6) e nënës dhe vëllait të bashkëshortit për çmimin mbi të cilin është paguar tatim (2.000.000 lekë). Shitja e apartamentit ka ndodhur në 2004, por dhurimi është deklaruar në DIPP-në e vitit 2005.”

të ekzistencës së saj. Fakti që subjekti nuk ka përdorur asnjë mekanizëm ligjor në dispozicion, madje as nuk e ka ngritur këtë pretendim gjatë hetimit, por edhe fakti që mbi atë kontratë për të cilën vihet në dyshim autenticiteti, vjehrra e subjektit ka paguar detyrimin tatimor, e çojnë Kolegjin në përfundimin se ky pretendim nuk paraqitet seriozisht, por si një shkak për të shmangur përgjegjësinë që vjen nga kjo rrethanë.

ii.) *Lidhur me pasurinë apartament me sip. 115,9 m², në rrugën “{***}” (ish-rruga “{***}”), Shk. {***}, K. {***}, Ap. {***}, Durrës:*

32. Komisioni, në vendimin e tij lidhur me këtë pasuri, ka konkluduar se: [...] *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë të pasurive apartament, njësi shërbimi dhe garazh, në deklaratat periodike ndër vite, në kundërshtim me pikën 5/a të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime fiktive me lidhjen e dy kontratave me çmime të ndryshme për shitjen e së njëjtës pasuri, njësisë me sip. 23,79 m², duke pasqyruar në kontratën përfundimtare të shitjes së vitit 2012 një çmim shumë herë më të ulët se çmimi i pasqyruar në kontratën e premtimshitjes së vitit 2008, me qëllim shmangien nga pagimi i tatimit mbi të ardhurat për çmimin real të përfituar. [...] Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të vlerës së investimit në deklaratat periodike dhe në deklaratën “vetting”, në kundërshtim me pikën 5/a të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 473.000 lekë për pagesën në shumën 20.000 euro në vitin 2006. [...] Subjekti i rivlerësimit është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit, kur ka gjykuar çështjen me palë shtetasin P. Ll., njëkohësisht administrator/ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK, me të cilin ka pasur dhe vijonte të kishte marrëdhënie interesi të vazhdueshme, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.*
33. Subjekti i rivlerësimit në ankim, për kundërshtimin e vlerësimit që ka bërë Komisioni për këto pasuri, pretendon se:
- 33.1. Pasaktësitë në sipërfaqe, në deklarimin e vitit 2005, kanë ardhur për shkak se apartamenti nuk ishte regjistruar si planimetri më vete dhe nuk ishin përcaktuar sipërfaqet e apartamenteve apo njësisve që do të përfitoheshin në mënyrë përfundimtare.
- 33.2. Lidhur me vlerësimin e Komisionit se pasuritë nuk janë deklaruar në deklaratën e vitit 2009, ky konkluzion nuk është i vërtetë, pasi sipërfaqet e përfituara në bazë të kontratës së shkëmbimit, janë deklaruar pranë ILDKPKI-së në vitin 2010, kur subjekti është thirrur për të dhënë sqarime mbi kontrollin e saktësisë së deklarimeve periodike. Gjithashtu, në deklaratën *vetting* janë pasqyruar saktësisht pasuritë dhe sipërfaqet e tyre, sipas dokumenteve hipotekore mbi bazën e të cilave janë regjistruar këto pasuri.
- 33.3. Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se ka bërë deklaram të pasaktë të vlerës së investimit në deklaratat periodike dhe në deklaratën *vetting*, subjekti pretendon se ka pasur burime financiare

të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e blerjes së apartamentit, shpenzimet e arredimit dhe shlyerjen e kësteve të kredisë bankare.

33.4. Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se ekzistenca e dy kontratave të ndryshme për shitjen e njësisë së shërbimit, është bërë me qëllim shmangien e pagesës së detyrimeve tatimore, subjekti parashtron se shumën nga shitja e njësisë e ka përfituar të gjithën, në vlerë të plotë prej 23.000 eurosh, nga kontrata e premtimshitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.11.2008. Kontrata e shitblerjes e vitit 2012 nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike apo financiare për subjektin, por vetëm për bashkëpronaren tjetër të njësisë, e cila nuk e kishte përfituar ende shumën e kësteve të mbetura nga blerësi. Dyshimi i Komisionit për kontratë fiktive për shmangien e tatimfitimit mbetet i paprovuar me asnjë provë apo indicie konkrete, pasi subjekti e ka paguar detyrimin që i takonte, përndryshe nuk do të mund të realizohej transaksioni në hipotekë.

33.5. Lidhur me konkluzionin e Komisionit për kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin P. Ll., subjekti parashtron se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie personale me këtë shtetas dhe se marrëdhënia juridike për ndërtim në truallin e trashëguar, ka qenë me shoqërinë “{***}” ShPK, pavarësisht se kush ka qenë ortak apo administrator i saj. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja, sqaron se vendimi i dhënë prej saj nuk ka shqyrtuar në themel çështjen, por vetëm vendimmarrjen e organit të prokurorisë për mosfillim procedimi. Gjithashtu, subjekti thekson se rastet e heqjes dorë të gjyqtarit nuk bazohen te ligji nr. 9367 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, por te Kodi i Procedurës Penale.

- 34.** Në kuadër të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me pasuritë e paluajtshme apartament me sip. 115,9 m², njësi shërbimi me sip. 23,79 m² dhe garazh me sip. 19,4 m², duke marrë në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin e Komisionit dhe arsyetimin e këtij të fundit në vendim, Kolegji vëren se:

Lidhur me konkluzionin e Komisionit se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë të pasurive:

- 35.** Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka pasur detyrimin të deklarojë këto pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, kur është lidhur kontrata e shkëmbimit, pasi ishte dokumenti i cili përcaktonte në mënyrë të saktë dhe të qartë pasuritë e përfituara nga subjekti dhe sipërfaqet e tyre. Gjithashtu, në deklaramet e pasurive në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të saktë në lidhje me sipërfaqet përkatëse.
- 36.** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në Komision, si dhe në ankimin drejtuar Kolegjit, se pasuritë në fjalë nuk i ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009, duke menduar se i ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005. Për deklarimin e apartamentit me sip. 120 m² në deklaratën e vitit 2005, subjekti ka shpjeguar se është i njëjti me atë me sip. 115,9 m², sipas dokumentit të hipotekës, dhe që me ambientet e përbashkëta shkon në sip. 120 m². Ndërsa njësinë dhe vendparkimet subjekti

parashtron se i ka deklaruar në vitin 2005, por pa përcaktuar qartë pjesët përkatëse. Sipërfaqet e përfituara në bazë të kontratës së shkëmbimit, lidhur më datë 16.04.2009, janë deklaruar pranë ILDKPKI-së në vitin 2010, kur subjekti është thirrur për të dhënë sqarime mbi kontrollin e saktësisë së deklarimeve periodike. Gjithashtu, në deklaratën *vetting* janë pasqyruar saktësisht pasuritë dhe sipërfaqet e tyre, sipas dokumenteve hipotekore mbi bazën e të cilave janë regjistruar këto pasuri.

37. Nga aktet në fashikujt e Komisionit, rezulton se në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar pronësinë 100% mbi apartamentin me sip. 115,9 m², si dhe mbi garazhin me sip. 19,4 m², në bashkëpronësi në pjesë të pandara me shoqërinë “{***}” ShPK. Për këto pasuri, subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja, ka deklaruar se janë përfitur si bashkëpronare e truallit, në bazë të kontratës së shkëmbimit nr. {***}, datë 16.04.2009, dhe se vlera tjetër e paguar për të është 10.000 euro.
38. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e vitit 2005, ka deklaruar: *Përfitur apartament 3+1, me sip. 120 m² në tokën të cilën e kam trashëgim, pjesë nga nëna ime. Toka është në bashkëpronësi, e regjistruar në hipotekë në datën 17.9.2001, përfitur falas një dyqan 12 m² dhe garazh. Përfitur falas 30 m², pjesa tjetër do të paguhet. Pjesa takuese: 50%. Subjekti, në po të njëjtën deklaratë, ka deklaruar: Për sip. 90 m² të apartamentit me sip. 120 m², do të paguaj vlerën 37.000 euro. Në dhjetor të vitit 2005, paguar pjesa I prej 10.000 eurosh (kredi në NBG), pjesa tjetër do paguhet gjatë vitit 2006. Kontrata përfundimtare do bëhet më vonë.*
39. Në deklaratën vjetore 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shitur një dyqan (1/2 pjesë) me kontratë premtimshetjeje, me nr. rep. {***}, kol. {***}, dt. 12.11.2008. Vlera 23.000 euro. Pjesa takuese 50%. Detyrime: [...] Më 22 prill 2008, është disbursuar një kredi në shumën 30.000 euro, më dt. 21.11.2008 është bërë shlyerja e pjesshme e kredisë, në shumën 25.000 euro. Fondet janë siguruar nga shitja e dyqanit [...].*
40. Gjithashtu, nga aktet në fashikuj, Kolegji konstaton se sipas aktit të kolaudit tekniko-ekonomik, objekti ka përfunduar në korrik të vitit 2005. Subjekti ka filluar të banojë në vitin 2005 në apartamentin me adresë në ish-rrugën “{***}”, sot rr. “{***}”, Shk. {***}, K. {***}, Ap. {***}, Durrës, siç konfirmohet dhe nga adresa e deklaruar në deklaratën vjetore 2005, dhe në vazhdim në deklaratat e viteve 2006, 2007, 2008.
41. Në vështrim të këtyre deklarimeve, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009, fitimin e pronësisë mbi pasuritë e mësipërme, në kundërshtim me detyrimet ligjore që burojnë nga neni 4 i ligjit nr. 9049/2003. Për shkak se objekti i kontrollit të deklarimeve për efekt të këtij procesi, janë deklarimet në deklaratën *vetting*, ky konstatim, ndonëse është i njëjtë me atë që bën edhe Komisioni, nuk mund të përbëjë një shkelje të ligjit sipas parashikimit të nenit 33, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht këtij qëndrimi, Kolegji vëren se fakti që subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009, viti kur ka fituar pronësinë me kontratën e shkëmbimit mbi këto pasuri, asgjë rreth këtyre fakteve juridike që kanë prodhuar të drejtat për të,

i ka vënë në vështirësi organet e rivlerësimit për të kontrolluar vërtetësinë e deklarimeve dhe burimet e financimit për pasuritë e subjektit, për shkak të pamundësisë së përdorimit të DIPP-së së vitit 2009 si një provë në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

42. Për këto arsye, ndonëse nuk konsiderohet si një shkak që ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë subjektin për pasaktësi në deklarime, kjo është një rrethanë që duhet të konsiderohet në vlerësimin tërësor të këtij kriteri brenda procesit të rivlerësimit.

Lidhur me vlerën e investuar në apartamentin me sip. 115,9 m²:

43. Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë të vlerës së investimit në deklaratat periodike dhe në deklaratën *vetting*, në kundërshtim me pikën 5/a të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme, në shumën 473.000 lekë, për pagesën në shumën 20.000 euro në vitin 2006.

44. Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se ka mungesë burimesh të ligjshme për apartamentin me sip. 115,9 m², subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në ankim një analizë të hollësishme lidhur me të ardhurat gjatë kësaj periudhe, 2005-2006, sipas së cilës pretendon se ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e blerjes së apartamentit, shpenzimet e arredimit dhe shlyerjen e kësteve të kredisë bankare.

44.1. Kolegji, nga aktet në fashikujt e Komisionit, konstaton se në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për apartamentin me sip. 115,9 m², janë shpenzuar për punime shuma 10.000 euro, e marrë kredi, si dhe të ardhurat e marra nga shitja e një apartamenti. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, subjekti ka deklaruar se për kompletimin e apartamentit, ka marrë hua shumën 10.000 euro nga z. D. H..

45. Kolegji vëren se Komisioni përgjatë hetimit të kryer, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka paguar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, shumën prej 20.000 eurosh në vitin 2006, shumë që ka kaluar më datë 5.6.2006, në llogarinë në ProCredit Bank të personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, me përshkrimin: *2024029152 nga E. Kaja për P. Ll. kësti shtëpi*.

46. Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në Komision, kjo shumë e përdorur në këtë transfertë ka si burim shumën prej 41.000 eurosh, të depozituara *cash* në datën 8.10.2005 nga personi i lidhur. Për këtë vlerë, subjekti në pyetësorin nr. 2, ka shpjeguar se ka si burim depozitat e mbyllura në fund të vitit 2004 (605.000 lekë, tërhequr nga depozita e bashkëshortit në datën 17.12.2004 dhe në vlerën 5.000 euro, tërhequr nga depozita e subjektit në datën 23.11.2004) dhe shumën 4.000.000 lekë, të përfituar nga shitja e apartamentit me sip. 78,9 m² nga bashkëshorti i saj.

47. Pavarësisht shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni, për pagesën 20.000 euro, ka marrë në konsideratë si burim vetëm shumën 2.000.000 lekë, të njohur si të ardhur të ligjshme nga shitja e apartamentit në pronësi të bashkëshortit. Në përfundim, në analizën financiare, Komisioni, pas konvertimit të shumës 20.000 euro, në shumën 2.473.000 lekë, duke konsideruar të ardhura të

ligjshme shumë 2.000.000 lekë nga shitja e apartamentit të bashkëshortit në vitin 2004, si burim i deklaruar për punimet e kryera për apartamentin në Durrës, në vitin 2006, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme, në shumë 473.000 lekë⁴.

48. Sa më sipër, në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, Kolegji në vazhdim të qëndrimit të mbajtur më sipër në këtë vendim, ku ka konsideruar si të ardhur të ligjshme nga shitja e apartamentit në Durrës, në emër të bashkëshortit, vjehrrës dhe kunatit, vlerën 2.000.000 lekë, konkludon se është i bazuar vlerësimi i Komisionit se për pasurinë apartament me sip. 115,9 m², në Durrës, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, në shumë 473.000 lekë, për pagesën lidhur me investimet e kryera për mobilimin dhe punimet për këtë pasuri në vitin 2006 prej 20.000 eurosh, ose e konvertuar në 2.473.000 lekë.
49. Kolegji mori në shqyrtim edhe konkluzionin tjetër të Komisionit që lidhet me deklarin e pasaktë të vlerës së investimit për këtë pasuri në deklaratën *vetting* dhe ato periodike, dhe i rezultoi se ky konkluzion është i drejtë. Nga analizimi i deklarinave të subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, në deklaratat periodike në vite, rezulton se pas deklarimit që ajo ka bërë në vitin 2005, se i detyrohet shoqërisë ndërtimore në vlerën prej 27.000 eurosh, për përfitimin e pasurisë apartament, vlerë e cila sipas po këtij deklarimi, do të shlyhej brenda vitit 2006, nuk ka më gjurmë të deklarinave në vite rreth kryerjes së këtij shpenzimi. Nga hetimi i Komisionit, ka rezultuar se subjekti nëpërmjet një transferte bankare, ka bërë një pagesë të këtij detyrimi në vlerën prej 20.000 eurosh, të përshkruar më sipër në vitin 2006, por e padeklaruar në DIPP-në e vitit 2006, në kundërshtim me detyrimet ligjore që i buronin nga ligji nr. 9049/2003 për deklarimin e shlyerjes së detyrimeve financiare në vitin korrent. Ndërsa ka rezultuar kjo situatë nga aktet bankare të administruara gjatë hetimit dhe të pranuar edhe prej vetë subjektit, në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja, deklaroi se vlera e paguar prej saj si shpenzim për fitimin e pasurisë apartament përtej kontratës së shkëmbimit, është vetëm 10.000 euro, vlerë e cila, siç ka rezultuar nga hetimi, është paguar prej subjektit që në vitin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes dhe deklaruar prej saj si e paguar që në DIPP-në e vitit 2005. Në këto kushte, pavarësisht mosdakordësisë me qëndrimin e Komisionit se deklarimet e pasakta të subjektit në deklaratat periodike përbëjnë një shkak për ta kualifikuar atë nën parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, deklarimi i paplotë dhe i pasaktë i vlerës së investimit për këtë pasuri në deklaratën *vetting*, plotëson kondicionin ligjor për të qenë nën parashikimin e këtij neni. Për këto shkaqe, Kolegji e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit për këtë pjesë.

Lidhur me shitjen e njësisë së shërbimit:

50. Komisioni ka konkluduar se *subjekti ka bërë deklarin të pasaktë të pasurisë njësi me sip. 23,79 m², pasi nuk ka deklaruar shitjen përfundimtare të saj në DIPP-në e vitit 2012, nëpërmjet kontratës*

⁴ Në vendim, Komisioni është shprehur: “1.15.3.1 Pas prapësimeve, për sa u shpjegua më sipër, Komisioni rishikoi analizën financiare nga ku rezultoi se për pagesën e shumë 20.000 euro, ose të konvertuar në 2.473.000 lekë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë mungesë burimesh të ligjshme në shumë 473.000 lekë, pasi të ardhurat e ligjshme nga shitja e apartamentit janë në shumë 2.000.000 lekë. (2.000.000 – 2.473.000 = - 473.000 lekë).

së shitblerjes, e cila pasqyronte një çmim të ndryshëm, dukshëm më të vogël, nga kontrata e premtimshitjes e vitit 2008. Subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime fiktive me lidhjen e dy kontratave me çmime të ndryshme për shitjen e së njëjtës pasuri, njësisë me sip. 23,79 m², duke pasqyruar në kontratën përfundimtare të shitjes së vitit 2012, një çmim shumë herë më të ulët se çmimi i pasqyruar në kontratën e premtimshitjes së vitit 2008, me qëllim shmangien nga pagimi i tatimit mbi të ardhurat për çmimin real të përfituar.

51. Në mbështetje të konkluzionit të mësipërm, Komisioni ka vendosur të mos përfshijë në analizën financiare shumën 23.000 euro pasi nuk plotëson kushtin e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për t'u konsideruar e ardhur e ligjshme, duke marrë për bazë deklaratimet e subjektit në seancën dëgjimore se ka përfituar shumën 23.000 euro në vitin 2008, për të cilën nuk ka paguar tatim, dhe se pagesa e tatimit është bërë për shumën e deklaruar në kontratën e vitit 2012, nga e cila subjekti nuk ka përfituar të ardhura.
52. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën e vitit 2012 të shitjes së njësisë, subjekti në Komision ka prapësuar se shitja e njësisë është deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 dhe, duke mos pasur pakësime/shtesa, e ka konsideruar të panevojshëm deklarimin në vitet e mëpasshme dhe kjo nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike apo financiare te subjekti. Ndërsa për sa i përket njësisë me sip. 23,79 m², ashtu si dhe parashtron subjekti, nga aktet rezulton se është deklaruar shitja në DIPP-në e vitit 2008, sipas kontratës premtimshitjeje nr. {***}, datë 12.11.2008.
53. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, i ka kërkuar subjektit që të shpjegojë mospërputhjen lidhur me çmimin e shitjes së njësisë së shërbimit me sip. 23,79 m². Subjekti ka shpjeguar se: *Lidhur me shumën e shënuar në vlerën prej 2.659.959 lekësh, në kontratën përfundimtare të shitjes së dyqanit, unë nuk kam dijeni përse kjo shumë është shënuar si çmim total i sendit, pasi vlera e saktë e çmimit të shitjes është ajo e kontratës së premtim shitjes, prej së cilës unë së bashku me babain tim kam përfituar shumën totale prej 23.000 mijë eurosh. Kjo shumë e deklaruar në kontratën e shitblerjes, kam menduar se përfaqëson vetëm shumën që unë kam përfituar nga pjesa ime e bashkëpronësisë. Nuk jam thelluar të analizoj çmimin në konvertim të shumës nga euro në lekë, por kam marrë parasysh vetëm shumën e përfituar me anë të kontratës së premtimshitjes. Kjo edhe për faktin se diferenca në kohë, nga momenti i lidhjes së kontratës së premtimshitjes, nuk ishte e vogël, pasi kontrata e premtimshitjes është e datës 12.11.2008 dhe kontrata përfundimtare është lidhur në datën 31.5.2012.*
54. Lidhur me konstatimin e Komisionit se ekzistenca e dy kontratave është bërë me qëllim shmangien nga pagimi i detyrimit tatimor, subjekti në Komision ka prapësuar se ka përfituar vetëm shumën 23.000 euro me kontratën e vitit 2008, ndërsa tatimi është paguar me depozitim të kontratës së shitblerjes të vitit 2012, dhe për çmimin e pasqyruar në këtë kontratë, në vlerën 2.659.959 lekë.
55. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin drejtuar Kolegjit, parashtron se nuk ka dijeni përse shuma prej 2.659.959 lekësh është shënuar si çmim total, pasi vlera e saktë e çmimit të shitjes është ajo e kontratës së premtimshitjes, prej 46.000 eurosh. Shuma prej 23.000 eurosh, dhënë nga blerësi për

subjektin e rivlerësimit që në vitin 2008, ka shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë më datë 22.04.2008, dhe kjo vërtetohet nga shkresat e Bankës NBG, datë 11.03.2009 dhe 18.10.2016, të cilat sqarojnë se në datë 21.11.2008, klienti ka bërë shlyerje të pjesshme të kredisë në shumën 25.000 euro, fonde të siguruara nga shitja e një dyqani (*korrigjuar nga apartament*).

56. Lidhur me shkaqet e mësipërme të ankimit, nga aktet në fashikull, Kolegji konstaton si më poshtë.

56.1. Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar apartamentin e regjistruar në emër të tij, me sipërfaqe 55 m², me adresë: Ap. {***}, K. 3, L. {***}, {***}, Durrës, me burim krijimi të ardhurat familjare dhe kredi në Bankën NBG. Sipas këtij deklarimi: *një pjesë e kredisë është deklaruar se është shlyer me lekët e marra sipas kontratës së shitjes (premtimshitjes) së një dyqani, një pjesë të të cilit bashkëshortja e ka përfitur si bashkëpronare e truallit [...], shitur me kontratën nr. rep.{***}, kol. {***}, datë 31 maj 2012, me vlerën 2.659.959 lekë.*

56.2. Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Shitur një dyqan (1/2 pjesë) me kontratë premtimshitjeje, me nr. rep. {***}, kol. {***}, datë 12.11.2008, me vlerë 23 mijë euro, pjesa takuese 50%.*

56.3. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndryshime të pasurive dhe burimit të krijimit.

56.4. Me kontratën e premtimshitjes nr. {***} rep., kol. {***}, datë 12.11.2008, të lidhur para noterit publik M. Rr., shitësit R. H., M. C. dhe Eda Kaja premtojnë se pjesën takuese, me sip. 22,5 m² në dyqanin nr. 9, do t'ia shesin shtetasit I. Ll., me një çmim 46 mijë euro. Pagesa do të bëhet në tri këste, dhe këstin e parë prej 35.677 eurosh, pala blerëse e ka parapaguar jashtë zyrës noteriale. Palët kanë rënë dakord që nga vlera e pagesës së këstit të parë, në shumën 35.677 euro, shumën 23 mijë euro ta marrin bashkëpronarët e truallit, Eda Kaja dhe M. C., dhe diferencën bashkëpronarja tjetër R. H..

56.5. Në kontratën për shitblerjen e pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.05.2012, rezulton se shitësit Eda Kaja, R. H. dhe shoqëria “{***}” ShPK, në bashkëpronësi në 1/3 pjesë të barabarta, i kanë shitur shtetasit I. Ll. njësinë e shërbimit nr. 9, me sip. 23,79 m², me çmim shitjeje 2.659.959 lekë. Në këtë kontratë nuk ka asnjë referencë të kontratës së premtimshitjes, si dhe të ndonjë kësti të parapaguar më parë nga blerësi.

56.6. Nga certifikata e pronësisë, pasuria njësi shërbimi me sipërfaqe 23,79 m², e ndodhur në zonën kadastrale nr. {***}, pasuria nr. {***}, rezulton se është në bashkëpronësi, në pjesë të barabarta të bashkëpronarëve R. H., “{***}” ShPK dhe Eda Kaja.

56.7. Subjekti ka depozituar në Komision deklaratën noteriale, datë 24.8.2021, me deklarues shtetasin I. Ll., i cili deklaron se ka marrë në dorëzim dyqanin me sip. 22,5 m², në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, 12.11.2008, dhe i ka paguar tërësisht palës shitëse *cash* këstin e parë,

në shumën 35.675 euro, dhe sipas kësaj kontrate, shumën 23.000 euro e kanë marrë *cash* në dorë Eda Kaja (Canhas) dhe M. C.

57. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të akteve të depozituara në Komision, Kolegji vlerëson se:

57.1. Provohet nga aktet e administruara se objekti njësi tregtare, në bashkëpronësi të subjektit dhe dy shtetasve të tjerë, ka qenë pjesë fillimisht e një marrëveshjeje për premtimshitje, të hartuar mes palëve në vitin 2008, e më pas objekt i kontratës së shitjes mes po të njëjtave palë në vitin 2012. Dy kontratat e hartuara mes të njëjtave palë, ajo për premtimshitje dhe ajo e shitjes, përshkruajnë si çmim të transaksionit vlera të ndryshme. Kontrata e premtimshitjes përshkruan se objekti shitet për një vlerë prej 46.000 eurosh, nga të cilat subjekti ka përfituar vlerën prej 23.000 eurosh dhe bashkëpronarja H. diferencën, ndërsa kontrata e shitjes e vitit 2012, përcakton si çmim të shitjes së këtij objekti mes tre bashkëpronarëve, vlerën prej 2.659.959 lekësh. Lidhur me këtë transaksion, subjekti ka bërë deklarime për përfitimin e shumës prej 23.000 eurosh në DIPP-në e vitit 2008, dhe të shumës prej 2.659.959 lekësh në deklaratën *vetting*. Rezulton gjithashtu e provuar se detyrimet tatimore mbi të ardhurat e krijuara prej shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme janë paguar në vitin 2012, pas shitjes së saj, duke u llogaritur si vlerë e tatueshme, vlera e çmimit të shitjes së vendosur në këtë kontratë.

57.2. Në përmbledhje të këtyre fakteve, Kolegji arrin në konkluzionin se shuma e cila është deklaruar në organet tatimore dhe i është nënshtruar pagimit të detyrimeve tatimore, pas shitjes së kësaj pasurie, është vlera prej 2.659.959 lekësh, dhe kjo shumë do të duhet të konsiderohet si një e ardhur e ligjshme në kuptim të parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3 pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Konkluzioni i Komisionit se kjo vlerë duhet konsideruar 0, nuk gjendet i drejtë sipas vlerësimit të Kolegjit, duke qenë se mbetet fakt i provuar tjetërsimi i pasurisë dhe krijimi i të ardhurave prej këtij veprimi juridik të ligjshëm, të paktën deri në vlerën prej 2.659.959 lekësh.

57.3. Në mbështetje të këtij arsyetimi, Kolegji, në funksion të një qëndrimi garantist, e pa të arsyeshme të konsiderojë si të ardhur të ligjshme të subjektit, për efekt të analizës financiare, të gjithë vlerën e përfituar nga kontrata e shitjes së njësisë, përderisa kjo vlerë rezulton të jetë më e vogël se vlera prej 23.000 eurosh⁵, e cila rezulton të jetë përfituar prej subjektit nga tjetërsimi i kësaj pasurie që në vitin 2008. Kolegji e trajtoi dhe vlerësoi këtë të ardhur në këtë kontekst, me qëllim mosrëndimin e pozitës së subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, në terma financiarë, për mospagimin e të gjithë vlerës së detyrimit tatimor që duhej të paguhej nëse çmimi në kontratën e shitjes do të ishte ai i vendosur në kontratën për premtimshitje, sigurisht në optikën e besueshmërisë së fakteve të deklaruara prej subjektit dhe të pasqyruara në kontratën e premtimshitjes, për përfitimin prej saj të vlerës prej 23.000 eurosh.

⁵ Ose ekuivalenti në lekë prej 3.199.070 lekësh, sipas kursit të këmbimit të monedhës euro të datës 31.5.2012, sipas Bankës së Shqipërisë: 1 euro = 139,09 lekë.

57.4. Kolegji e vlerësoi si alogjik interpretimin e pjesës prej 1/3 të bashkëpronarit, shoqërisë “{***}” ShPK, në këmbim të një sipërfaqeje prej 1,29 m², duke pranuar në interpretim të termave të kontratës se bashkëpronarët dominues të kësaj pasurie, kanë qenë subjekti dhe R. H., midis të cilave është shpërndarë vlera e çmimit të shitjes së saj.

58. Për arsyet e mësipërme, Kolegji çmon se në zbatim të pikës 3 të nenit D të Kushtetutës dhe legjislacionit tatimor në fuqi, të ardhurat që janë deklaruar nga shitja sipas kontratës së vitit 2012, në vlerën 2.659.959 lekë, duhet të konsiderohen si të ardhura të ligjshme dhe të përfshihen në analizën financiare të vitit 2008, sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit, si burim për shlyerjen e kredisë në Bankën NBG.
59. Pavarësisht këtij konkluzioni, Kolegji e konsideron të drejtë qëndrimin e Komisionit se subjekti ka marrë pjesë në hartimin e kontratave fiktive, me synim zvogëlimin e vlerës mbi të cilën do të paguhej detyrimi tatimor. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, për padijeni apo për faktin se ajo nuk ka përfituar më të ardhura të tjera nga transaksioni i kryer në vitin 2012, nuk janë bindëse dhe as të arsyeshme për Kolegjin, konsideruar faktin se subjekti ka nënshkruar në këtë kontratë me cilësinë e palës shitëse, si edhe njohuritë e posaçme të fushës të cilat nuk justifikojnë shpjegime të kësaj natyre.

Lidhur me konkluzionin e Komisionit për kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin P. Ll.:

60. Komisioni ka konstatuar gjatë hetimit administrativ se subjekti i rivlerësimit, referuar vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 19.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka gjykuar çështjen me ankues P. V. Ll., administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK.
61. Komisioni në përfundim ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja, është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit, kur ka gjykuar çështjen me palë shtetasin P. Ll., njëkohësisht administrator/ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK, me të cilin ka pasur dhe vijonte të kishte marrëdhënie interesi të vazhdueshme, në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
62. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit, ashtu si edhe gjatë hetimit dhe seancës dëgjimore, ka parashtruar se çështja gjyqësore që ka iniciuar shtetasi P. Ll., lidhet me një ankim të tij kundër një vendimi mosfillimi të organit të prokurorisë për materialin kallëzues të këtij shtetasi ndaj një shtetasi tjetër, pronar kufitar me pronën e tij, për mosrespektim të legjislacionit për urbanistikën. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie personale me shtetasin P. Ll. dhe marrëdhënia juridike për ndërtimin në truallin në pronësi ka qenë me shoqërinë, pavarësisht se kush ka qenë ortak apo administrator i saj. Me vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, nuk është shqyrtuar në themel çështja, por vetëm vendimmarrja e prokurorisë për mosfillim të procedimit, dhe nuk ka ardhur asnjë pasojë juridike për ndonjë palë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se në rastin konkret, rastet e heqjes dorë të gjyqtarit nga shqyrtimi

i një çështjeje nuk bazohen në ligjin nr. 9367 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, por nga Kodi i Procedurës Penale, i cili është ligji procedural penal që një gjyqtar duhet të zbatojë përgjatë ushtrimit të funksionit të tij.

63. Kolegji, nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, konstaton se, me vendimin gjyqësor nr. {***}, datë 19.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja, si gjyqtare e vetme, ka gjykuar çështjen me ankues P. V. Ll. dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesës me objekt: “Kundërshtim i vendimit për materialin kallëzues nr. {***}, datë 04.05.2018”, si të pabazuar në prova dhe në ligj. Po nga këto akte, rezulton se shtetasi P. Ll. është ortak/administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, me të cilën subjekti ka pasur marrëdhënie kontraktore disavjeçare, si pasojë e dhënies së një trualli si bashkëpronare për ndërtim, si dhe aktualisht një marrëdhënie bashkëpronësie mbi garazhin me sip. 19,4 m².
64. Kolegji konsideron se shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të subjektit duhet bërë në raport me dispozitat e ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të Kodit të Procedurës Penale, të cilat përcaktojnë kushtet dhe procedurat për deklarimin dhe shmangien e konfliktit të interesit të gjyqtarëve, si dhe të heqjes dorë nga shqyrtimi i çështjes. Në nenin 3, pikat 1 dhe 4 të ligjit 9367, parashikohet se: 1. *“Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisive të tij publike [...] 4/b) “konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësisive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë [...].* Ndërsa në nenin 13 të këtij ligji parashikohet se: 2. *Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas këtij kreu, bëhen vetëm për ato veprime, që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara, sipas rastit, në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe të legjislacionit që rregullon procesin e hetimit parlamentar.* Ndërkohë, Kodi i Procedurës Penale, në nenin 17 përcakton se: *Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete [...] ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.*

Në rastin konkret, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka pasur një marrëdhënie të mëparshme kontraktore me shoqërinë “{***}” ShPK, e cila ka përfunduar në vitin 2009, me kontratën e shkëmbimit të pasurisë truall me apartamentin dhe garazhin, në bashkëpronësi në këtë të fundit. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është zhvilluar në vitin 2018, disa vite pasi kushtet e marrëdhënies së shkëmbimit dhe të bashkëpronësisë ishin vendosur, jashtë çdo ndikimi të mundshëm ndaj ndonjë interesi të subjektit. Nisur nga të dhënat e mësipërme, në mungesë të rrethanave që dëshmojnë ndonjë interes pasuror nga subjekti në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe nga fakti që nga vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit, shtetasi P. Ll. nuk ka pasur asnjë

përfitim, përkundrazi vendimmarrja ka shkuar në dëm të interesave të këtij shtetasi, Kolegji vlerëson se rrethanat e përshkruara nuk mund të konsiderohen si shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, në kuptim të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale, që do të sillnin detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të hequr dorë nga shqyrtimi i çështjes gjyqësore dhe, për pasojë, konkluzioni i Komisionit se kjo rrethanë duhet konsideruar si një shkak për vendosjen e masës disiplinore ndaj subjektit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, gjendet i pabazuar në prova e në ligj.

iii.) Lidhur me kredinë bankare, marrë pranë NBG Bank Durrës, për blerjen e një apartamenti të përbashkët, të regjistruar në emër të bashkëshortit:

65. Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit se është i pabazuar konkluzioni i Komisionit se ka mungesë burimesh të ligjshme për shlyerjen e kredisë bankare, të marrë pranë NBG Bank Durrës. Komisioni, në vendim, për shlyerjen e kësaj kredie, ka konkluduar: *7.9 Komisioni vlerëson se edhe pas prapësimeve dhe shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës për mungesën e burimeve të ligjshme për shlyerjen e kredisë sepse të ardhurat e përfituara nga shitja e dyqanit në shumën 23.000 euro, në analizën financiare janë llogaritur në shumën 0 (zero) lekë, pasi për këtë shumë nuk është paguar tatim - konfirmuar nga subjekti. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për shlyerjen e kredisë në shumën 2.834.520 lekë [...] Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 2.834.520 lekë, për shlyerjen e kredisë me të ardhurat e përfituara nga shitja e dyqanit.*
66. Lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, subjekti shprehet në ankim se nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni argumentet e parashtruara në lidhje me shitjen e njësisë së shërbimit, me kontratën e premtimshitjes së datës 12.11.2008, me vlerë 23 mijë euro.
67. Në lidhje me këtë shkak ankimi, nga shqyrtimi i akteve të hetimit administrativ, rezulton se subjekti ka deklaruar në deklaratën vetting: *Kredi bankare pranë NBG Bank Durrës, 22.4.2008, me qëllim blerjen e një apartamenti të përbashkët të regjistruar në emrin e bashkëshortit.* Subjekti, bashkë me deklaratën vetting ka depozituar kontratën e kredisë, datë 17.4.2008, me kredidhënës Bankën NBG dhe kredimarrësit Eda dhe E. K., për kredinë në shumën 30.000 euro, me qëllim blerjen e apartamentit me sip. 55 m², në Lagjen {***}, {***}, Durrës, me afat shlyerjeje 20 vjet.
68. Në deklaratën vjetore 2008, subjekti ka deklaruar: *Shitur një dyqan (1/2 pjesë) me kontratë premtimshitjeje me nr. rep {***}, kol. {***}, dt. 12.11.2008. Vlera 23.000 euro. Pjesa takuese 50%. Detyrime: Vazhdim shlyerje kredie marrë nga Banka NBG (vijon) nga dhjetor 2005 deri në 21 prill 2008. Më 22 prill 2008, është disbursuar një kredi në shumën 30.000 euro, më dt. 21.11.2008 është bërë shlyerja e pjesshme e kredisë në shumën 25.000 euro. Fondet janë siguruar nga shitja e dyqanit. Këstet, paguar gjatë vitit 2008, për kreditë, është 1.080 euro. 4.474,49 euro, teprica e kredisë në dhjetor 2008.*

69. Kolegji shqyrtoi këtë shkak ankimi në referim të qëndrimit të mbajtur në lidhje me shkakun tjetër të analizuar më lart, për shitjen e njësisë së shërbimit, të trajtuar më sipër në këtë vendim, në paragrafët 50-58. Sipas qëndrimit të mësipërm, i cili konsideroi sipas një fryme garantiste, si të ardhur të ligjshme nga shitja e njësisë, çmimin e shitjes së njësisë sipas kontratës së shitjes së njësisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.05.2012, prej 2.659.959 lekësh, dhe duke pranuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, i cili e lidh shlyerjen e kredisë me shumën e përfituar nga shitja e njësisë së shërbimit, Kolegji çmon se duke konsideruar këtë vlerë, ndryshe nga qëndrimi i mbajtur prej Komisionit, subjekti arrin të provojë shlyerjen e pjesëshme të kredisë deri në masën e 2.659.959 lekëve.
70. Për sa i përket pjesës tjetër të kredisë, sipas analizës financiare të kryer në Kolegj, duke konsideruar si të ardhur të ligjshme në vitin 2008, vlerën nga shitja e njësisë në Durrës prej 2.659.959 lekësh, bazuar në deklarinimin e subjektit të rivlerësimit se këto të ardhura janë përdorur si burim për shlyerjen e pjesëshme të kredisë në ish-NBG Bank, në vlerën prej 26.450 eurosh, të depozituar në *cash* në bankë, më datë 21.11.2008 (*ekuivalenti në lekë 3.259.698, me kursin e datës së kryerjes së transaksionit sipas publikimit nga Banka e Shqipërisë*), Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit përsëri rezulton me një balancë negative prej 599.739 lekësh, të pambuluar me burime të ligjshme.
71. Në përfundim të sa më sipër, Kolegji, lidhur me shlyerjen e pjesëshme të kredisë bankare në NBG Bank në vitin 2008, pavarësisht se njohu si të ligjshme një pjesë të të ardhurave të krijuara nga shitja e njësisë 23,79 m², rruga “{***}”, Durrës, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit sërish gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.
- iv.) Lidhur me apartamentin e regjistruar në emër të bashkëshortit, me sipërfaqe 55 m², Ap. {***}, K. {***}, me adresë: L. {***}, {***}, Durrës, me burim krijimi të ardhurat familjare dhe kredi në Bankën NBG:*
72. Komisioni, për këtë pasuri, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare pasi me të ardhurat familjare të përfituara në vitin 2008, nuk mund të përballonte shpenzimet dhe të paguante për mobilimin e apartamentit, në shumën 1.059.400 lekë.
73. Lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ankimon analizën financiare të vitit 2008, në të cilën pretendon se nuk janë konsideruar: i) të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit, të pasqyruara në dokumentacionin e tatimeve; ii) të ardhurat e përfituara nga shitja e njësisë në shumën 23.000 euro, të cilat kanë qenë burim për shlyerjen e kredisë bankare në shumën 25.000 euro; iii) nuk është konsideruar gjendja e likuiditeteve në fillim të vitit 2008, të cilat janë mbartur që nga viti 2003 (pretenduar në analizën financiare të vitit 2003). Sipas subjektit, vlera e pasurisë, pa përfshirë arredimin, është 3.690.000 lekë, dhe diferenca përbën shpenzimet për arredim, të cilat nuk janë kryer të gjitha në vitin 2008. Lidhur me analizën financiare të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se duke marrë në konsideratë të ardhurat dhe gjendjen e likuiditeteve *cash* të mbartur ndër vite, të cilat janë të ligjshme pasi mbi këto të ardhura janë

paguar tatimet përkatëse, rezulton me një balancë negative prej 773.283 lekësh, për shkak të pasaktësisë në deklarimin e vitit 2007, duke mos deklaruar kursimet *cash* në fund të vitit.

74. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që vlerësimi i situatës financiare si më sipër të bëhet duke konsideruar shpjegimet e dhëna në ILDKPKI, në datën 20.10.2010, ku ka shpjeguar se: *Në DIVP-në e vitit 2008 kam deklaruar blerjen e një apartamenti në plazh, për të cilin kam përdorur një kredi prej 30.000 eurosh, si dhe gjendjen cash 1.000.000 lekë, të mbetur nga viti i mëparshëm 2007. Problemi i mosjustifikimit ka dalë pasi nuk kam plotësuar saktë deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, duke mos deklaruar gjendjen cash.*
75. Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në e vitit 2008, ka deklaruar blerjen e apartamentit të ndodhur në lagjen {***}, {***}, Durrës, me vlerë 41.600 euro. Po në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vazhdimin e shlyerjes së kredisë së marrë nga Banka NBG, nga dhjetori 2005 deri më 21 prill 2008. Më 22 prill 2008, është disbursuar një kredi në shumën 30.000 euro dhe më dt. 21.11.2008, është bërë shlyerja e pjesësme e kredisë në shumën 25.000 euro, me fonde të cilat janë siguruar nga shitja e dyqanit.
76. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Apartament i regjistruar në emër të E. K., me nr. pasurie {***}, e ndodhur në zonën kadastrale {***}, me sip. 55 m². Adresa: lagjja nr. {***}, {***}, Durrës. Apartament nr. {***}, kati {***}, v. {***}, faqe {***}, me numër hipotekor {***}. I blerë me kontratën e shitblerjes me nr. rep. {***}, kol. {***}, datë 14/04/2008. Vlera 3.690.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi: I blerë me të ardhurat familjare, si dhe me kredi bankare, provuar me vërtetimin e bankës NBG, datë 18.10.2016. Një pjesë e kësaj kredie është shlyer me lekët e marra sipas kontratë së shitjes (premtimshitjes) së një dyqani, një pjesë të të cilit bashkëshortja ime e ka përfitur si bashkëpronare e truallit mbi bazën e kontratës së shkëmbimit të bërë me aktin noterial nr. {***}, datë 16.04.2009, me palën shkëmbyese me firmën e ndërtimit “{***}” ShPK, shitur me kontratën me nr. rep. {***}, kol. {***}, datë 31.05.2012, me vlerën 2.659.959 lekë. Ndërsa në rubrikën “Detyrime”, subjekti ka deklaruar: *Kredi bankare e marrë pranë NBG Bank, Durrës, 22.04.2008, me qëllim blerjen e një apartamenti të përbashkët të regjistruar në emër të bashkëshortit. Mbetur pa shlyer 3.128,21 euro. Kësti mujor 33 euro. Provuar me vërtetimin lëshuar nga NBG Bank, kontratë kredie dhe kontratë hipotekore. Vlera 3.128,21 euro.**
77. Në shqyrtim të pretendimit se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë gjendjen e likuiditeteve në fillim të vitit 2008, të cilat janë të mbartura që nga viti 2003, Kolegji, nga analizimi i deklaratave periodike të subjektit, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditete *cash*, si në deklaratën fillestare të deklarimit të pasurisë në vitin 2003, ashtu dhe në deklaratat periodike për vitet 2004 - 2016. Lidhur me detyrimin për deklarimin e likuiditeteve *cash*, sillet në vëmendje se ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, sipas përcaktimeve të tij në fuqi për periudhën në shqyrtim (2003-2008), në nenin 4 parashikonte: *Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës*

31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]. Formulari i deklarimit të pasurisë (prej vitit 2004), në faqen 3, ka përshkruar mënyrën se si duhen deklaruar interesat, duke iu referuar nenit 4, shkronjat a, b, c, ç, d të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003. Për sa parashikuar më sipër, ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit të interesave privatë përcaktojnë detyrimin e zyrtarit deklarues të deklarojë, midis të tjerave, sipas rastit, gjendjen e likuiditeteve *cash*. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratën vjetore të vitit 2003 e deri në vitin 2007, të cilat të mund të konsideroheshin në analizën financiare të vitit 2008, Kolegji çmon si të drejtë konkluzionin e Komisionit që nuk i ka konsideruar si burime të ligjshme dhe nuk ka përfshirë në analizën financiare gjendjen e likuiditeteve të pretenduara për vitin 2008. Kolegji përsërit në këtë rast qëndrimin e tij të konsoliduar⁶ se nuk mund të prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike. Aq më tepër, Kolegji nuk mund të pranojë ekzistencën e këtyre likuiditeteve, të cilat nuk janë deklaruar në deklaratat periodike prej subjektit, si e vetmja formë që mund të provonte ekzistencën e tyre. Pretendimi i subjektit se për konsiderimin e kësaj gjendjeje *cash* të padeklaruar në asnjë deklaratë periodike, të konsiderohet deklarimi i bërë në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në vitin 2010, gjendet nga Kolegji i pambështetur në ligj, për sa kohë që ligji ka përcaktuar një detyrim eksplicit të subjekteve deklaruese, për të deklaruar pasuritë e tyre në vite, përfshirë pasurinë likuiditet në gjendje *cash*, dhe ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 5 e tij, u jep vlerën e provës *prima facie*, pikërisht këtyre deklaratave periodike, të cilat prezumohen se janë përpiluar në përputhje me kërkesat e ligjit. Deklarimet e kryera përgjatë proceseve verifikuese në ILDKPKI, janë konsideruar prej Kolegjit si elemente ndihmëse në sqarimin dhe saktësimin e deklarimeve të bëra në deklaratat periodike, kur ato kanë qanë të paqarta apo të paplota, por në asnjë rast ato nuk janë konsideruar si deklarime origjinare të kryera prej subjekteve, për sa kohë që edhe janë përfutur pas një procesi provokues/pyetës të organit kompetent. Për këto arsye, pretendimi i subjektit për të konsideruar si deklarime rishtas të gjendjes *cash*, shpjegimet e dhëna gjatë pyetjes në ILKDPKI në vitin 2010, u konsiderua i pambështetur në ligj, duke abstraguuar në këtë rast edhe inkonsistencën e subjektit në raport me këto shpjegime, për të cilat në parashtrime jep një version të ri të të kuptuarit, të papretenduar më parë as në hetim dhe as në ankimin e paraqitur.

78. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizë të të ardhurave nga aktiviteti privat i bashkëshortit, referuar trajtimit në vijim në çështjen e ankimit lidhur me të ardhurat nga bashkëshorti E. K., si ortak i vetëm i shoqërisë "{***}" ShPK, në vlerën 10.002.316 lekë, në analizën financiare të kryer në Kolegji për vitin 2008, janë konsideruar të ardhurat nga aktiviteti i

⁶ Vendimet e Kolegjit nr. 7/2019(JR), paragrafi 32.5; nr. 29/2019 (JR), paragrafi 31; nr. 1/2020 (JR), paragrafi 50; nr. 31/2021 (JR), paragrafi 25.2; nr. 26/2022 (JR), paragrafi 18.7.

bashkëshortit të subjektit, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni në analizën e vitit 2008 dhe në përputhje me qëndrimin e mbajtur lidhur me këtë shkak ankimi, i cili do të trajtohet në vijim.

79. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji konsiderimin në analizë të të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortit në vitet 2006-2009, specifikisht në analizën e vitit 2008, në vlerën prej 510.185 lekësh. Konstatohet se kjo vlerë e pretenduar në analizë nga subjekti i rivlerësimit, i referohet deklaratës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël, të datës 31.03.2009, të konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës⁷, që lidhet me vitin 2008, i cili është fitimi i vitit duke zbritur tatimin mbi të ardhurat personale (në shifra: 566.872 lekë – 56.687 lekë = 510.185 lekë). Pas analizës ligjore të kryer, Kolegji konkludoi se në analizën financiare të këtij viti, duhet të përfshihet vlera prej 518.872 lekësh, e cila është vlera e fitimit të vitit 2008, prej 566.872 lekësh, duke zbritur parapagimet prej 48.000 lekësh. Në këto kushte, në analizën e vitit 2008, në Kolegj u konsiderua si e ardhur nga aktiviteti i bashkëshortit, vlera prej 518.872 lekësh.
80. Në përfundim, lidhur me analizën financiare të vitit 2008, duke konsideruar në analizën financiare të vitit, të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i bashkëshortit, në shumën 518.872 lekë sipas përlllogaritjeve të Kolegjit, duke konsideruar vlerën e shitjes së njësisë së shërbimit në Durrës sipas kontratës së shitjes, prej 2.659.959 lekësh, si të ardhur të ligjshme, duke mos konsideruar përdorimin e likuiditeteve *cash* prej 1.000.000 lekësh të mbartura nga viti 2003, apo dhe 1.000.000 lekë të mbartura nga viti 2007, në kushtet kur nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore por dhe në deklaratën *vetting* si burim, të padeklaruara më parë ndër vite në deklaratat vjetore, si dhe duke lënë elementet e analizës financiare njësoj si ka konsideruar dhe Komisioni, por dhe subjekti i rivlerësimit në ankim, rezulton një diferencë negative në vlerën (-) 1.957.950 lekë, vlerë kjo më e vogël nga vlera prej (-) 5.136.781 lekësh, për të cilën ka konkluduar Komisioni.

v.) *Lidhur me të ardhurat nga shitja e aksioneve të kantinës së pijeve “{***}”, në emrin e subjektit dhe të bashkëshortit:*

81. Subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij, në kuadër të kundërshtimit të vlerësimit që Komisioni i ka bërë krijimit të kësaj pasurie në formën e zotërimit të aksioneve në një shoqëri aksionare, ka parashtruar se aksionet janë deklaruar pranë ILDKPKI-së, sipas procesverbalit të vitit 2010, si dhe janë deklaruar në deklaratën *vetting*, në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari”, ku janë cilësuar si të ardhura të bashkëshortit, punonjës i kantinës, (paga+aksione) nga muaji janar 1994 - prill 2002. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se me privatizimin e kantinës së pijeve “{***}”, së bashku me bashkëshortin kanë përfituar 100 aksione, me kuotë pjesëmarrjeje secili 0,015. Si aksionarë të shoqërisë, subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur funksione në organe drejtuese apo ekzekutive të shoqërisë, nuk kanë përfituar dividendë apo ndonjë përfitim tjetër nga këto aksione. Subjekti i rivlerësimit parashtron në Kolegj se vetëm fakti i tjetërsimit të aksioneve pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, tregon sjelljen e tij për të shmangur mundësitë e lindjes së një konflikti interesi.

⁷ Shkresa nr. {***} prot., datë 06.05.2021, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

82. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga shitja e aksioneve të Kantinës së Pijeve {***} sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., kol. {***}. Në emër tim dhe të bashkëshortit, në masën 50% secili – shuma 100.000 lekë. Ndërsa personi i lidhur, bashkëshorti, ka deklaruar: Të ardhura në vite si punëtor pranë kantinës së pijeve “{***}”, nga muaji janar i vitit 1994 - prill të vitit 2002 (paga + aksionet). Shuma 1.003.028 lekë.*
83. Subjekti, bashkë me deklaratën *vetting*, ka depozituar deklaratën noteriale, datë 10.12.2007, në të cilën shtetasit E. dhe Eda Kaja deklarojnë se secili është aksionar me nga 50 aksione (ku secili prej tyre përfaqëson 0,015%) të kapitalit të shoqërisë anonime kantina e pijeve "{***}" ShA, Durrës, dhe se këto aksione do të shiten në shumën 100.000 lekë në datën e kësaj deklarate.
84. Komisioni në vendim, lidhur me aksionet dhe të ardhurat nga shitja e tyre, ka konkluduar: *Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, në prapësime dhe në seancë dëgjimore, nuk ka shpjeguar mosdeklarimin e aksioneve në DIPP-të e viteve 2003 - 2009, si dhe nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me mospagimin e tatimit mbi të ardhurat nga shitja. Ndërkohë, në lidhje me papajtueshmërinë e funksionit të gjyqtarit (gjendjen e konfliktit të interesit), subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse dhe Komisioni vlerëson se papajtueshmëria ka qenë prezente dhe se subjekti nuk duhet të kishte qenë aksionare në kantinën e pijeve "{***}" ShA. Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të zotërimit të aksioneve në deklaratat periodike në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë së funksionit të gjyqtarit në zotërimin e aksioneve të kantinës së pijeve "{***}", në kundërshtim me ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008 (i ndryshuar).*
85. Për sa konstatohet nga aktet në fashikull dhe në vendimin e Komisionit, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte zotërimin e aksioneve të përfituara nga privatizimi që në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003, si dhe të pasqyronte në deklaratën periodike vjetore 2007, edhe shitjen e aksioneve, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 10.12.2007. Por, pavarësisht mungesës së deklaramit në deklarata periodike vjetore, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar aksionet që zotëronte së bashku me bashkëshortin në deklaratën *vetting* dhe në procesverbalin e vitit 2010, të mbajtur në ILDKPKI gjatë kontrollit nga ky institucion si subjekt deklarues. Për pasojë, Kolegji, ashtu si edhe më sipër, konsideron se mosdeklarimi i zotërimit dhe shitjes së aksioneve në deklaratat periodike, pavarësisht detyrimit sipas ligjit nr. 9049/2003, për t'i deklaruar ato, nuk e vendos subjektin në kushtet e deklaramit të pasaktë sipas nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që nuk ngrihet ndonjë çështje lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për fitimin e tyre.
86. Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore që kanë lindur për shkak të krijimit të të ardhurave nga shitja e aksioneve, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit jo vetëm nuk arriti të provojë pagesën e detyrimeve tatimore për vlerën 100.000 lekë të shitjes së aksioneve, por nuk ka dhënë asnjë sqarim dhe asnjë dokument provues për të provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit. Në analizë të ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga shitja e aksioneve, rezulton se edhe pse Kolegji, bazuar në deklaratën *vetting*,

konsideron se subjekti e ka plotësuar detyrimin për deklaram, mbetet e paprovuar që të jetë bërë pagesa e tatimeve për këto të ardhura, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”. Për këto arsye, Kolegji çmon se është i bazuar qëndrimi i Komisionit për moskonsiderimin e këtyre të ardhurave si të ligjshme dhe mospërfshirjen e tyre në analizën financiare të vitit 2007, kur është bërë edhe shitja e tyre.

87. Për sa i përket gjendjes së konfliktit të interesit, Kolegji çmon se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar në ligj. Zotërimi i aksioneve nga subjekti dhe bashkëshorti ka ardhur si pasojë e ligjit për privatizimin dhe marrëdhënies së punësimit që bashkëshorti ka pasur në kantinën e pijeve “{***}”. Vlera e ulët dhe e papërfillshme e aksioneve, fakti që këto aksione janë përfituar nga ligji, moskrijimi i ndonjë të ardhure apo pasurie prej tyre, roli pasiv që subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur në administrimin e shoqërisë, si dhe shitja e menjëhershme e aksioneve, në vitin 2007, pas konstatimit të konfliktit të interesit, e përjashtojnë subjektin e rivlerësimit nga situata e konfliktit të interesit, e parashikuar në shkronjën “d” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

vi.) Lidhur me automjetet në emër të bashkëshortit të subjektit:

88. Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me automjetet në deklaratat periodike vjetore, në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit me targë {***}, në shumën 108.342 lekë, dhe blerjen e automjetit me targë {***}, në shumën 672.730 lekë, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
89. Subjekti ka parashtruar në Komision se automjeti me targë {***}, është blerë në vitin 2009, në shumën 5.000 euro, me të ardhura të realizuara nga shitja e makinës së mëparshme me targë {***}. Shumën e përfituar nga shitja e automjetit me targë {***}, subjekti pretendon se bashkëshorti e ka marrë para se të finalizohet kontrata e shitjes, dhe për këtë ka paraqitur si provë para Komisionit deklaratën noteriale të blerësit K. A.. Ndërsa si burim për blerjen e automjetit me targë {***}, subjekti ka sqaruar se janë të ardhurat vjetore për vitin 2004. Subjekti parashtron se mosdeklarami i blerjes së automjetit në vitin 2004, nuk është bërë për shkak se diferenca në çmim me automjetin e mëparshëm, të deklaram në vitin 2003, ishte shumë e vogël.
90. Për sa i përket pagesës me vonesë të tatimit mbi shitjen e automjeteve, subjekti, në ankimin e paraqitur në Kolegji, parashtron se nuk ka pasur dijeni për detyrimin e pagimit të tatimit, pasi nuk është vënë në dijeni nga autoritetet përkatëse, por as ligji i tatimit mbi të ardhurat dhe as udhëzimi nr. 5/2006 i ministrit të Financave nuk parashikonin raste të pagimit të tatimit për automjetet. Menjëherë sapo është njohur me detyrimin ligjor, subjekti ka kryer pagesën e detyrimeve tatimore për vlerën e përfituar nga shitja e automjeteve.
91. Nga verifikimi i akteve të fashikullit të Komisionit, Kolegji konstaton se në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaram: *Makinë tip “Mercedes Benz C Class”, viti i prodhimit 2001, ngjyrë gri, marka “Daimler Crysler”, tipi 2003, modeli C200CD, me targë {***}, i blerë më 11.10.2009, me*

të ardhurat e realizuara nga shitja e makinës së mëparshme, bashkëngjitur formularit dokumenti justifikues. Vlera: 5.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi: Blerë me të ardhurat e realizuara nga shitja e makinës së mëparshme, bashkëngjitur formularit dokumenti justifikues.

92. Në deklaratën vjetore 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Blerje, makinë e vitit 2001, vetë në Gjermani (bashkëshorti). Vlera 5.000 euro + 350.000 lekë dogana, si dhe: Shitur makinë e tipit “Benz Mercedes”, me kontratën e shitblerjes me nr. rep. {***}, kol. {***}, 1.000.000 lekë të reja. Në deklaratën e vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar blerjen e automjetit “Mercedez Benz 250 D”, me targë {***}.*
93. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision mandatpagesën e kryer për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të detyrimeve tatimore të tri automjeteve të tjetërsuara, midis tyre, të dy automjeteve, me targa {***} dhe {***}, në datën 30.03.2021, në shumën totale 222.291 lekë. Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit të datës 30.08.2021, në pyetjen nr. 11, është shprehur se bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur dijeni për detyrimin për pagesën tatimore, pasi ligji dhe kontrata nuk e shprehnin në mënyrë eksplicite, si dhe ka bashkëlidhur aktet: a) urdhër pagesë 1500, tatim i mbajtur në burim për periudhën tatimore korrik 2021, për tatim për kalimin e së drejtës së pronësisë me shitje, me detyrimin principet 222.291 lekë [përlllogaritur nga subjekti në formë tabele dhe në përgjigjet e pyetësorit, datë 30.08.2021, si total të diferencave të çmimit të shitjes – çmimin e blerjes së automjeteve me 15% tatimin], duke përfshirë interesin (329 lekë) dhe gjatë (1.334 lekë) deri më 30.08.2021, total prej 223.954 lekësh; b) pagesë në Raiffeisen Bank, datë 30.08.2021, për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me urdhëruese F. Y., vlera prej 223.954 lekësh dhe komisionet me përshkrimin: [...] *Eda Kaja, pagesë tatimi, mbajtur në burim. Targa {***} – {***}, korrik 2021.*
94. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, lidhur me konkluzionin e Komisionit se subjekti ka bërë deklaratë të pamjaftueshëm, Kolegji konstaton se pavarësisht disa mangësive në deklaratat e viteve 2003 dhe 2004, në të cilat nuk janë pasqyruar blerjet e automjeteve, me targë {***} dhe “Mercedes Benz 250 D”, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar makinën që ka pasur në pronësi në momentin e deklaramit, si dhe burimin e krijimit të saj, me të ardhurat e realizuara nga shitja e makinës së mëparshme. Po kështu, nga aktet, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e makinës tip “Mercedes Benz C Class”, viti i prodhimit 2001 në DIPP-në e vitit 2009, si dhe po në këtë deklaratë edhe shitjen e makinës së mëparshme “Mercedes Benz 250 D”, të vitit 1992, me targë {***}.
95. Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për pagesën e detyrimeve tatimore, nga aktet e administruara në Komision, rezulton se sipas mandatpagesës për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e automjeteve më datë 30.03.2021, duke u konsideruar si vlerë e tatueshme diferenca mes çmimit të shitjes dhe blerjes së automjeteve. Për sa i përket pagesës me vonesë të detyrimeve tatimore, Kolegji, në vendimin nr. 15/2021 ka mbajtur qëndrimin orientues se: [...] *në referim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të*

ardhurave të krijuara, Kolegji çmon se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Së dyti, në konsideratë të organeve të rivlerësimit duhet të mbahet sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtij kriteri, do të duhet të vlerësohen rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo **paqartësie** apo një qëllim për t'u arritur. Në vështrim të këtij qëndrimi, Kolegji vëren se në rastin konkret, ashtu si dhe është shprehur subjekti i rivlerësimit në ankim, legjislacioni tatimor ka qenë i paqartë nëse të ardhurat nga shitja e automjetit ishin të ardhura të tatueshme, si dhe për autoritetin pranë të cilit do të kryhej pagesa e detyrimeve tatimore. Nga dispozitat e ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, konkretisht të nenit 8 të tij, në të cilin listohen të ardhurat e tatueshme, nuk rezulton që të ketë një parashikim të qartë për të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurive të luajtshme, ku përfshihen dhe automjetet. Kjo paqartësi e dispozitës ka sjellë si pasojë mosveprimin e subjektit të rivlerësimit për pagesën e tatimit në kohën e krijimit të të ardhurave nga shitja. Në këndvështrim të këtyre parashikimeve ligjore, të cilat nuk rezultojnë të kenë një parashikim eksplicit për detyrimin tatimor që lind në raste të tilla⁸, as për agentin tatimor dhe as për procedurën tatimore, por edhe në konsideratë të rrethanave faktike të rastit objekt gjykimi, në të cilat subjekti, pavarësisht këtij ambiguiteti ligjor, është ofruar dhe ka paguar vullnetarisht detyrimin tatimor të supozuar, Kolegji çmon se duhen konsideruar si të ardhura të ligjshme, të ardhurat e krijuara nga shitja e automjeteve të mësipërme, pavarësisht diferencës mes çmimeve të blerjes dhe shitjes së tyre. Për sa më sipër, Kolegji, nisur nga rrethanat konkrete dhe në respektim të standardit kushtetues të parashikuar nga neni 155 i Kushtetutës⁹, çmon se të ardhurat e realizuara nga shitja e dy automjeteve, me targa {***} dhe {***}, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, duhen të konsiderohen se plotësojnë kriterin e së ardhurës së ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si të tilla, duhet të përfshihen në analizën financiare të vitit 2009, për të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {***}, sipas kontratës së datës 15.07.2009, me vlerë prej 1.000.000 lekësh, dhe të vitit 2014 për të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {***}, sipas kontratës së datës 14.06.2014, me vlerë prej 5.500 eurosh ose ekuivalenti prej 770.605 lekësh.

96. Të njëjtin qëndrim mban Kolegji edhe lidhur me automjetin tip “Ford RTB”, të vitit 1999, dhuruar nga vjehrra e subjektit të rivlerësimit, për të ardhurat nga shitja e të cilit Komisioni ka konkluduar

⁸ Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në shkresën nr. {***} prot., datë 06.04.2018, drejtuar KPK-së, shprehet se: “Për sa i përket tatimit mbi të drejtën e kalimit të pronësisë së automjetit, në legjislacionin tatimor nuk ka parashikim as të ardhurat personale të tatueshme, neni 8, dhe as të ardhurat personale të përjashtuara, neni 8/1 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Në rast se do të ketë fitime nga shitja e pasurisë së paluajtshme, atëherë individit përfitues i kësaj të ardhure do i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale në masën 15% të fitimit”.

⁹ Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Në këto raste, ligjit nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese.

se nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme, për shkak të mospagimit të tatimit mbi të ardhurat nga shitja.

vii.) *Lidhur me të ardhurat në vlerën 10.002.316 lekë të bashkëshortit të subjektit, si ortak i vetëm i shoqërisë “{***}”:*

97. Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka dalë në konkluzionin se të ardhurat e shoqërisë “{***}” ShPK, për periudhën 3.07.2006 – 21.12.2009, në shumën 10.002.316 lekë, të pretenduara nga subjekti, për shkak të mosshpërndarjes së dividendit dhe pagimit të tatimit përkatës, nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, për këtë arsye, nuk i ka marrë në konsideratë në analizën financiare. Komisioni, duke vlerësuar se nuk qëndron pretendimi i subjektit se nuk ka pasur detyrimin të paguajë dividendin, ka konkluduar se është forma ligjore e shoqërisë ajo që përcakton mënyrën e tërheqjes së fitimit të realizuar dhe si rrjedhojë edhe detyrimin e pagimit të tatimit mbi këtë fitim, dhe jo përgjegjësia tatimore siç referohet subjekti.
98. Në ankimin drejtuar Kolegjit, subjekti i rivlerësimit parashtron se bazuar në përgjigjet e dhëna nga organet tatimore dhe Bashkia Durrës, del qartë që bashkëshorti ka pasur të ardhura dhe fitim për të cilat është paguar tatimi i thjeshtuar i fitimit. Edhe nëse do të ishte subjekt i tatimit mbi dividendin, përsëri e ardhura neto pas pagimit të tatimit të thjeshtuar të fitimit, do të tatohej sërish me tatimin mbi dividendin, por nuk do të zerohej, siç ka vepruar Komisioni. Sipas ligjit të kohës, shoqëria nuk ka pasur detyrim për të paguar tatim mbi dividendin, si biznes i vogël dhe, në këto kushte, e ardhura neto pas pagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, ka qenë më e madhe.
99. Kolegji vëren se në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *Gjatë periudhës në të cilën unë kam qenë ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK, subjekti ka realizuar të ardhura në masën 10.002.316 lekë, periudhë kjo që daton nga 03.07.2006 - 21.12.2009, bashkangjitur shkresa e datës 25.10.2016 me nr. prot. {***} dhe shkresa nr. {***}, datë 21.10.2016. Fitime nga të ardhurat e shoqërisë sipas shkresës së datës 25.10.2016, me nr. protokolli {***}. Vlera 10.002.316 lekë.*
100. Në deklaratat periodike ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar te seksioni i të ardhurave: i) Në DIPP-në e vitit 2006: *paga vjetore nga puna e bashkëshortit si instruktor në autoshkollën “{***}”, 25.000 lekë në muaj.* ii) Në DIPP-në e vitit 2007: *Të ardhura nga bashkëshorti, i cili ushtron aktivitetin privat, i pajisur me licencën nr. {***} NIPT, autoshkolla “{***}”{***}. Xhiro vjetore 3.200.000 lekë, fitimi vjetor 1.400.000 lekë.* iii) Në DIPP-në e vitit 2008: *Të ardhura nga bashkëshorti, i cili ushtron aktivitetin privat, me licencë nr. {***} NIPT {***}, autoshkolla “{***}”, fitimi 1.207.303 lekë, tatimi mbi të ardhurat 120.730 lekë.* iv) Në DIPP-në e vitit 2009: *Të ardhura nga bashkëshorti, i cili ushtron aktivitetin privat, autoshkolla “{***}”, xhiro vjetore 2.415.000 lekë, fitimi vjetor 479.504 lekë. Rroga mujore 50.000 lekë.*

101. Kolegji konstaton se sipas akteve¹⁰ në fashikull, shoqëria “{***}” ShPK, për periudhën 2006-2009, kur subjekti pretendon të ardhurat e përfituara, ka qenë i regjistruar si biznes i vogël, i paregjistruar si tatimpagues për TVSh. për shkak të këtij statusi që lidhet me llojin dhe përmasat e aktivitetit, sipas legjislacionit tatimor dhe tregtar, shoqëria, në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, e ndryshimeve të tij, ka qenë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, nga data 23.04.2004 – 01.01.2008, e më pas i tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël, për periudhën 2008-2009¹¹, parashikime ligjore që kanë qenë në fuqi e janë zbatuar në kohën gjatë së cilës është ushtruar aktiviteti i pretenduar.

101.1. Në kushtet e mësipërme, për periudhën për të cilën janë realizuar të ardhurat nga shoqëria (vitet 2006-2009), detyrimi për pagesën e tatimit mbi të ardhurat, sipas legjislacionit në fuqi, ka qenë:

- Për vitet 2006-2007, shoqëria ka qenë subjekt i pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Sipas legjislacionit në fuqi për këtë periudhë, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin zbatohet ndaj tatimpaguesve që nuk ishin të regjistruar ose të detyruar me ligj për t'u regjistruar si tatimpagues për tatimin mbi vlerën e shtuar, pavarësisht nga forma e organizimit të personit juridik. Pagesa e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin parashikohet të bëhet në formë parapagimesh, të ndara në katër këste tremujore gjatë vitit, ndërsa për tatimpaguesit që realizonin xhiro vjetore mbi 8.000.000 lekë dhe të regjistruar në TVSh, legjislacioni parashikonte pagesën e tatimit mbi fitimin. Për këta tatimpagues, udhëzimi nr. 5/2006 i ministrit të Financave parashikonte se: "Në zbatim të nenit 33/1 të ligjit, tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin, brenda datës 31 korrik të çdo viti, duhet të depozitojnë pranë Degës së Tatimeve, vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë të kapitalit dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi". Nga nenet 32/1 dhe 33/1 të ligjit 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe nga udhëzimi nr. 5/2006 i ministrit të Financave, rezulton se shpërndarja e dividendit dhe pagesa e tatimit mbi dividendin realizohej vetëm nga shoqëritë tregtare që ishin subjekt i tatimit mbi fitimin, pra për shoqëritë që realizonin xhiro vjetore mbi 8.000.000 lekë.

- Për vitet 2008-2009, pas zëvendësimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me taksën vendore për biznesin e vogël, si dhe me ndryshimin e neneve 8 dhe 12 të ligjit 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007, personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, të cilët realizonin një qarkullim vjetor jo më shumë se 8.000.000 lekë dhe jo më pak se 2.000.000 lekë, u bënë subjekte të tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël. Të ardhurat e tatueshme, të realizuara gjatë periudhës tatimore nga subjektet e taksës vendore mbi biznesin e vogël, llogariteshin si diferencë ndërmjet të ardhurave, total, me shpenzimet e njohura. Sipas këtyre dispozitave, të ardhurat nga biznesi i vogël konsideroheshin si të ardhura personale dhe këto ishin të vetmet të ardhura të tatueshme për

¹⁰ Shkresa nr. {***}, datë 20.02.2020, e QKB-së dhe shkresa nr. {***}, datë 06.05.2021, e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Durrës.

¹¹ Të ndara këto periudha sipas ndryshimeve në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat".

efekt të tatimit mbi të ardhurat personale. Duke marrë në konsideratë se edhe dividendi përfaqëson një tatim mbi të ardhurat personale, nuk mund të prezumohej që i njëjti subjekt t'i nënshtrohej dy herë tatimit mbi të ardhurat personale, duke pagur si tatimin e të ardhurave nga biznesi i vogël, ashtu edhe, siç arsyeton Komisioni, tatimin mbi dividendin.

102. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson si të pabazuar në ligj edhe konkluzionin e Komisionit se është forma ligjore e shoqërisë ajo që përcakton mënyrën e tërheqjes së fitimit të realizuar. Nga ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, rezulton se ndarja e përgjegjësisë tatimore, pra nëse një shoqëri do të jetë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin apo i tatimit mbi fitimin, bëhet jo sipas formës juridike të shoqërisë, por sipas xhiros vjetore që realizon shoqëria, si dhe nga fakti nëse është ose jo subjekt i TVSh-së. Shoqëria "{***}" ShPK, si biznes i vogël i paregjistruar në TVSh, nuk ka qenë subjekt i tatimit mbi fitimin, nuk ka shpërndarë dividend dhe, rrjedhimisht, nuk ka pasur detyrim për pagesë të tatimit mbi dividendin. Për këto arsye, Kolegji çmon se është i pabazuar konkluzioni i Komisionit se të ardhurat e shoqërisë nuk plotësojnë kriterin e të ardhurave të ligjshme për shkak se për to nuk është bërë pagesa e tatimit mbi dividendin, dhe vlerëson që këto të ardhura të përfshihen në analizën financiare të viteve përkatëse, 2006 – 2009.

viii.) Lidhur me blerjen e automjetit të personit të lidhur, djalit A.K., me burim krijimi të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm:

103. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, djali A.K., nuk kanë paguar tatimin mbi të ardhurat për diferencën e çmimit të blerjes me të shitjes së automjetit të mëparshëm dhe, për këtë arsye, si burim të ligjshëm për blerjen e automjetit të deklaruar në deklaratën *vetting*, ka konsideruar vetëm shumën 2.000 euro që i korrespondon çmimit të blerjes së automjetit të markës "Daimler Chrysler", viti i prodhimit 1999. Në përfundim, Komisioni ka arritur në konkluzionin se personi i lidhur, djali A.K., ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 3.500 euro për blerjen e automjetit.

104. Subjekti i rivlerësimit në ankim parashtron se lidhur me mungesën e burimeve financiare në shumën 3.500 euro, që ka ardhur si pasojë e mosnjohjes së tatimit të paguar me vonesë, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e djalit për vitin 2012 dhe janar 2013, nga punësimi pranë shoqërisë "{***}". Komisioni këto të ardhura përveçse nuk i ka përfshirë në tabelën e analizës financiare, nuk i ka marrë në konsideratë as si kursime për blerjen e automjetit.

105. Nga aktet e administruara, rezulton se në deklaratën *vetting*, personi i lidhur, A.K., ka deklaruar: *Makinë, model "Volkswagen", "Passat", me targë {***}, tipi 3C2, viti prodhimit 2008, blerë me kontratën e shitjes me nr. rep. {***}, kol. {***}, datë 16.06.2014. Vlera 5.500 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi: Blerë me lekët e rrjedhura nga shitja e makinës së mëparshme me kontratën me nr. {***} rep., kol. {***}, datë 14.06.2014, bashkangjitur dokumenti justifikues.*

106. Në deklaratën vjetore 2014, subjekti ka deklaruar: *Djali A.K. ka shitur një makinë të llojit autoveturë e markës "Daimler Chrysler", viti i prodhimit 1999, me naftë, me targë sot {***}. Kontratë shitjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 14.06.2014. Vlera 5.500 euro.*

*Blerje makine nga djali A.K., lloji autoveturë e markës “Volkswagen Passat”, me targë {***} dhe viti i prodhimit 2008 dhe naftë dhe ngjyrë blu. Kontratë shitje nr. rep. {***}, kol. {***}, datë 16.06.2014. Vlera 5.500 euro. Burimi dhe pjesa takuese nuk janë deklaruar. Në deklaratën vjetore 2013, subjekti ka deklaruar: I kam blerë djalin A. K. një autoveturë, e markës “Daimler Crysler”, viti i prodhimit 1999, me naftë, me targë sot {***}, vlera 2.000 euro.*

107. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar mandatin e pagesës së kryer për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, datë 30.8.2021, me përshkrim pagesë tatim i mbajtur në burim për automjetet, midis tyre dhe të automjetit me targë {***}.
108. Kolegji, sipas qëndrimit të mbajtur më sipër në paragrafin 96 të këtij vendimi për të njëjtën çështje, nga pikëpamja ligjore, çmon se edhe këto të ardhura duhen konsideruar se plotësojnë kriteret e së ardhurës së ligjshme, sipas parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.
109. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka konsideruar të ardhurat nga pagat e djalit si kursime për blerjen e automjetit, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit, të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit të mëparshëm, ndërsa gjatë seancave në Komision, si dhe në ankimin drejtuar Kolegjit, ka pretenduar si burim të ardhurat nga paga e djalit. Në kushtet e deklarimeve kontradiktore nga subjekti, Kolegji, mbështetur në deklaratën *vetting*, si dhe në deklaratimet periodike vjetore të subjektit, vlerëson se është i bazuar qëndrimi i Komisionit që nuk i ka marrë në konsideratë të ardhurat nga paga si burim për blerjen e automjetit, për sa kohë që personi i lidhur i ka specifikuar ato në deklaratën *vetting* si të krijuara nga shitja e automjetit të mëparshëm. Pavarësisht këtij konkluzioni, arsyetimi i mësipërm lidhur me legjitimitimin e të ardhurave nga shitja e automjetit në pronësi, të cilat janë përdorur për të blerë automjetin tjetër të deklaruar në deklaratën *vetting*, lë pa peshë dhe pa efekt konkluzionin lidhur me përcaktimin e burimit, duke qenë se personi i lidhur rezulton për shkak të këtij arsyetimi të ketë pasur burime të ligjshme për financimin e automjetit model *Volkswagen, Passat*, me targë {***}.
110. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të viteve 2012 dhe 2013, të ardhurat nga paga e djalit, Kolegji vëren se është i pabazuar, pasi Komisioni në vendim është shprehur se: *Subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat nga paga e djalit dhe, për këtë arsye, Komisioni i përfshiu në analizën financiare për vitin 2012, në shumën 210.576 lekë dhe për vitin 2013, në shumën 8.610 lekë.*

ix.) Lidhur me huatë e marra, në shumën 10.000 euro në vitin 2005 dhe 10.000 euro në vitin 2006, nga shtetasi D. H.:

111. Komisioni ka vlerësuar se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se huaja e marrë nga shtetasi D. H. është përdorur vetëm për shumën 3.000 euro, bie në kundërshtim me veprimet bankare, ku evidentohet se në datën 4.10.2005, bashkëshorti i subjektit ka kaluar 5.000 euro në depozitë, me afat nga huaja prej 10.000 eurosh, e marrë nga ky shtetas. Në përfundim, Komisioni për këtë hua ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokument ligjor mundësinë financiare të huadhënësit, por ka bërë

deklarim të pasaktë të huas së marrë nga shtetasi D. H., në kundërshtim me pikën 5, shkronja “a” e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

112. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion të Komisionit, duke parashtruar se gabimet apo harresat duhet të përfshihen në një gabim njerëzor që nuk ka të bëjë me asnjë aspekt të fshehjes apo deklarimit të rremë ose të pasaktë, si një deklaram të pamjaftueshëm të tillë që cenon standardet e nenit D të Kushtetutës dhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

113. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, Kolegji konstaton dhe analizon si vijon.

113.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja, nuk i ka deklaruar huatë e marra prej saj në vite. Në deklaratën e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Marrë borxh për kompletim të shtëpisë nga djali i tezes, D. H., 10.000 euro. Depozituar në ProCredit Bank shuma e marrë borxh, 10.000 euro [...].*

113.2. Sipas lëvizjeve të llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se në llogarinë në ProCredit Bank, është kredituar më datë 03.10.2005, vlera 10.000 euro, me përshkrimin: *[...] nga D. H. për E. K. [...]*, dhe në datë 29.12.2005, nga kjo llogari është kryer transferta në vlerën 7.000 euro, me përshkrimin: *[...] për D. H. nga E. K.* Huaja pasi është marrë, pjesërisht është investuar më datë 04.10.2005 në depozitë (5.000 euro), pjesa tjetër është tërhequr *cash* dhe, sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, është përdorur pjesërisht për pagesat për arredimin dhe pjesa tjetër për të rikrijuar gjendjen *cash* në banesë.

113.3. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në ILDKPKI në vitin 2010, se huaja e marrë në vitin 2005 është shlyer me 7.000 euro nga kredia e marrë në NBG Bank në dhjetor, ndërsa huaja e vitit 2006 është marrë vetëm për efekt vize në ambasadë dhe është kthyer menjëherë.

113.4. Në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se pjesa prej 3.000 eurosh i është kthyer huadhënësit në vitin 2006, ndërsa në deklaratën noteriale të datës 20.1.2020, huadhënësi D. H. ka deklaruar se shuma 3.000 euro është kthyer me shuma të vogla deri para pak kohësh. Lidhur me këtë deklaram të huadhënësit, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se bëhej fjalë për një lapsus të tij, pasi kjo shumë është kthyer që në vitin 2006.

113.5. Në referencë të akteve dhe deklarimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, Kolegji vlerëson se janë të pabazuara pretendimet e subjektit ndaj konkluzionit të Komisionit për deklaram të pasaktë të huave. Nga aktet, rezulton se subjekti ka qenë kontradiktor në deklarimet e tij lidhur me shlyerjen e huas së marrë në vitin 2005. Shuma e përdorur, e deklaruar prej tij, nuk i korrespondon shumës që rezulton nga transaksionet bankare, si dhe subjekti nuk ka qenë konsekuent në deklarimet e tij gjatë hetimit në Komision, po ashtu deklarimet e tij nuk mbështeten nga aktet e administruara.

113.6. Pavarësisht dakordësisë me qëndrimin e Komisionit lidhur me pasaktësi apo mospërputhje të deklarimeve të subjektit në lidhje me marrjen, destinacionin dhe shlyerjen e huas së marrë prej shtetasit D. H., atashimi i këtij konkluzioni për deklarime të pasakta në deklarimet periodike vjetore, me nenin

33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, gjendet nga Kolegji i padrejtë, duke përdorur të njëjtin arsyetim si në rastet e ngjashme të trajtuara më lart. Duke qenë se kjo hua është e shlyer prej subjektit që në vitet 2005-2006, nuk ka gjurmë të deklarimit të saj në deklaratën *vetting*, për pasojë konsiderohet pa relevancë. Konkluzioni i Komisionit lidhur me deklaratimet e subjektit për këtë hua, konsiderohet pa peshë në zgjidhjen e çështjes, përveç se kontrollit të tyre në funksion të përcaktimit të fondeve të përdorura për financimin e pasurisë, si një element që i shërben çështjes në vijim lidhur me analizën financiare.

113.7. Për pasojë, Kolegji e gjen këtë konkluzion të Komisionit të pambështetur dhe pa efekt në vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit.

x.) Lidhur me analizën financiare të kryer në Komision për periudhën 2003-2016:

114. Subjekti i rivlerësimit ka ankimuar analizën financiare totale të viteve 2003, 2005, 2006, 2009, 2014, të kryer nga Komisioni, sipas së cilës subjekti ka rezultuar me një balancë negative totale në vlerën 8.086.347 lekë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur, pretendimet e mëposhtme lidhur me elementet në analizën financiare të këtyre viteve.

114.1. *Përfshirjen në analizë të likuiditeteve “cash” të padeklaruara nga viti 2003 deri në vitin 2007, të cilat janë përdorur në vitin 2008.*

114.2. *Specifikimin e vlerës prej 730.338 lekësh, të pasqyruar në analizën financiare të vitit 2005 si shpenzime të tjera, pasi nuk është përcaktuar se çfarë shpenzimesh përfaqësojnë dhe si janë llogaritur.*

114.3. *Përfshirjen e të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortit në vitet 2006-2009, specifikisht në analizën e vitit 2006.*

114.4. *Të konsiderohen të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {***} në analizën e vitit 2014, në vlerën 770.605 lekë dhe jo 280.420 lekë, sipas përlllogaritjes së çmimit të blerjes sipas Komisionit, pasi subjekti ka paguar tatimin për diferencën e çmimit të shitjes me të blerjes në vitin 2021.*

114.5. *Në përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve Tims, në analizën e vitit 2014, me destinacion Italinë, të merren në konsideratë deklaratat noteriale të vjehrrës dhe dajës së bashkëshortit, te të cilët ka pretenduar se ka qëndruar subjekti i rivlerësimit, si dhe familja e tij.*

- **Lidhur me analizën financiare të vitit 2003:**

115. Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, në raport me analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe reflektoi në analizën e kryer në Kolegji, konkluzionet e mëposhtme në raport me secilin shkak ankimi të ngritur prej saj lidhur me zërat e analizës. Kolegji, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si Komisioni, sipas analizës lidhur me pasurinë apartament në {***}, Durrës, e mobilimin e saj në vitin 2008, nuk mori në konsideratë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e likuiditeteve *cash* të padeklaruara nga viti 2003 deri në vitin 2007, për shkak të mosdeklarimit të tyre në asnjë deklaratë periodike të shtjelluar më sipër

në arsyetim. Fakti i pretenduar nga subjekti se diferenca hipotetike pozitive e analizës financiare të vitit 2003, prej përreth 2 milionë lekësh, duhej të konsiderohej si mundësia e saj reale për kursim, por që nuk ishte deklaruar për shkak të një pasaktësie, u konsiderua për Kolegjin pa peshë në vlerësimin që i bëri këtij shkak. Kolegji nënvizon se kontrolli i pasurive të subjekteve bëhet mbi bazën e deklarimeve të tyre, veçanërisht për likuiditet në *cash*, të cilat verifikohen nëse subjektet kanë pasur ose jo mundësi t'i krijojnë me burime të ligjshme. Skenari i kundërt, që çdo tepricë apo balancë pozitive të konsiderohet se ka ekzistuar, nuk është i mbështetur në ligj dhe as në logjikë. Së pari, sepse këto pasuri nuk janë deklaruar, për pasojë në kuptim të këtij procesi, nuk kanë ekzistuar dhe së dyti, sepse analiza financiare mbi metodologjinë e përdorur nga organet e rivlerësimit, mbetet një standard ligjor/konvencion i përdorur/pranuar për të gjitha subjektet në të njëjtin nivel, por kjo nuk do të thotë se ajo i përgjigjet së vërtetës objektive të çdo individi. Për pasojë, ajo vlen për të kontrolluar, por jo për të prezumuar krijimin e pasurive të padeklaruar.

- **Lidhur me analizën financiare të vitit 2004:**

116. Kolegji, ashtu si dhe është trajtuar në paragrafin 30 të këtij vendimi, konfirmoi rezultatin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë rezultuar me një mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve për këtë vit, në vlerën prej (-) 1.746.922 lekësh.

- **Lidhur me analizën financiare të vitit 2005:**

117. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për mosspecifikimin e vlerës prej 730.338 lekësh si shpenzime të tjera në analizën financiare të vitit 2005, Kolegji konstaton se:

117.1. Komisioni, lidhur me këtë vlerë që korrespondon me pagesat e kryera me kartë në vlerën prej 5.960 eurosh nga ProCredit Bank, nga llogaria e bashkëshortit të subjektit, e ka pyetur subjektin e rivlerësimit, znj. Eda Kaja, në pyetësin nr. 2, datë 30.08.2021, dhe ajo është përgjigjur se: *Në lidhje me tërheqjen cash për periudhën 12.10.2005 - 03.11.2005, si dhe tërheqjet e datës 07.11.2005, dhe po kështu pagesa të kryera me kartë në shumën 5.960 euro në datat 14.11-18.11.2005 (në total 15.960 euro), sqaroj se si të burim të të ardhurave kanë shumën prej 41.000 eurosh të sqaruar më lart, si dhe huan e marrë nga D. H., në shumën prej 10.000 eurosh. Nga shumat e tërhequra cash dhe pagesat me kartë, sikurse kam deklaruar në pyetësin nr.1, shuma prej 10.000 eurosh është përdorur për arredimin e apartamentit ku unë banoj së bashku me familjen time, dhe pjesa tjetër është rikrijuar gjendje cash në shtëpi.*

117.2. Komisioni këtë vlerë e ka përfshirë dhe në analizën e rezultateve hetimore dhe ka shpjeguar në Aneksin e rezultateve hetimore, “Metodologjia e kryerjes së analizës financiare 2003 -2016”, në paragrafin 1.12, se: *Në shpenzime të tjera është marrë në analizë vlera 5.960 euro, sipas pagesave të kryera me kartë në Procredit Bank.*

117.3. Komisioni në vendim, në përgjigje dhe të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, ka sqaruar lidhur me këtë shpenzim se: *Në DIPP-në e vitit 2005, nuk rezulton deklarim i gjendjes*

cash dhe për këtë arsye, shuma 15.960 euro, e tërhequr cash/paguar me bankë nga subjekti në vitin 2005, është konsideruar si shpenzim në analizën financiare, nga ku shuma 10.000 euro është përdorur për mobilimin e apartamentit dhe pjesa tjetër prej 5.960 eurosh është shpenzuar.

117.4. Kolegji vlerëson se përderisa subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në fund të vitit 2005, tërheqjet e bëra nga llogaritë bankare, me të drejtë janë konsideruar prej Komisionit si shpenzime të kryera brenda këtij viti financiar duke pakësuar pasurinë likuiditet. Por qëndron edhe logjika se subjekti i rivlerësimit për periudhën deri në datën 07.11.2005, ka krijuar kursime *cash* të cilat i ka shpenzuar deri në fund të vitit, duke mos pasur gjendje *cash* për deklarim në fund të këtij viti. Nga veprimet e kryera në bankë, sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti, pjesa e pagesës me kartë ka qenë pjesë e pagesës prej 10.000 eurosh për mobilimin e apartamentit¹², dhe nuk do të ishte e mundur që pjesa tjetër, prej 5.960 eurosh (ose 730.338 lekësh), të jetë shpenzuar në total brenda vitit pasi të gjitha shpenzimet e vitit të evidentuara dhe përlllogaritura¹³ janë më pak se kjo vlerë. Në këto kushte, qëndron përfshirja e tërheqjeve *cash* nga banka si shpenzime të tjera të kryera gjatë vitit. Tërheqjet deri më datë 7.11.2005 nga llogaria, duke mos pasur informacion të plotë, konsiderohen se janë shpenzuar, dhe referuar shpenzimeve të përlllogaritura në analizë potencialisht do të kishin mbuluar shpenzimet e jetesës për familjen për muajt nëntor-dhjetor prej 73.038 lekësh, krahas shpenzimeve të tjera të deklaruara apo dokumentuara, duke ulur në këtë mënyrë diferencën negative të vitit 2005, të konstatuar prej Komisionit, nga (-) 187.422 lekë në (-) 114.384 lekë.

- **Lidhur me analizën financiare të vitit 2006:**

118. Subjekti i rivlerësimit në ankim lidhur me analizën financiare të vitit 2006, ka pretenduar se Komisioni nuk ka konsideruar të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit në vitet 2006-2009, specifikisht në analizën e vitit 2006 në vlerën prej 890.140 lekësh. Referuar analizës ligjore të kryer më lart, në përgjigje të shkakut të ankimit që lidhej me të ardhurat e bashkëshortit E. K., si ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk jep shpjegime për llogaritjen e kësaj vlere, duke iu referuar informacioneve që ka në fashikuj nga Drejtoria Rajonale Tatimore për vitet e mëvonshme 2008-2009, dhe duke konsideruar marzh fitimi (fitimi/shitje), për vitet për të cilat ka informacion, një mesatare prej ~ 18%¹⁴, Kolegji llogariti se për vitin 2006, do të rezultonte fitim prej 18% x 2.967.133 lekë xhiro e deklaruar = 534.084 lekë, duke zbritur tatimfitimin e thjeshtuar, të konfirmuar prej 44.507 lekësh, do të rezultonte fitim pas tatimit prej 489.577 lekësh. Kjo vlerë është e ndryshme nga vlera e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në analizën financiare të vitit 2006, e cila është afërsisht sa dyfishi i kësaj vlere të përlllogaritur, por nuk është e mbështetur në dokumentacion që provon normën e fitimit në këtë vit.

¹² I cili është përfshirë në analizën e vitit.

¹³ Si jetese, shkollimi apo për kredinë, janë në total 493.891 lekë.

¹⁴ Për vitin 2008, do të ishte 13% (fitimi 566.872 lekë/ shitje 4.305.000 lekë) dhe për vitin 2009, do të ishte 22% (fitimi 532.782 lekë/ shitje 2.415.000 lekë).

119. Referuar trajtimit më sipër në vendim për çështjen e ankimit lidhur me të ardhurat nga bashkëshorti E. K., si ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK, konkludohet se në analizën për vitin 2006, në Kolegj janë konsideruar të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit të subjektit, ndryshe nga sa konkluduar nga Komisioni në analizën e vitit 2006, në të cilën nuk janë përfshirë të ardhura nga ky aktivitet.

120. Sa më sipër, lidhur me analizën financiare të vitit 2006, të kryer në Kolegj duke reflektuar konkluzionet e mësipërme, subjekti dhe personat e lidhur, në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni për një balance negative prej (-) 128.537 lekësh, do të rezultonte me balancë pozitive.

- **Lidhur me analizën financiare të vitit 2009:**

121. Subjekti i rivlerësimit pretendon përfshirjen në analizë të të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortit në vitet 2006-2009, specifikisht në analizën e vitit 2009, në vlerën prej 479.504 lekësh. Vlera e pretenduar në analizë nga subjekti i rivlerësimit, i referohet informacionit të konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, deklaratës për të ardhurat e biznesit të vogël për vitin 2009¹⁵, dhe është llogaritur duke zbritur nga fitimi i vitit tatimin mbi të ardhurat personale (në shifra: 532.782 lekë – 53.278 lekë = 479.504 lekë). Kjo e ardhur e pretenduar është deklaruar edhe nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009. Referuar trajtimit në çështjen e ankimit lidhur me të ardhurat nga bashkëshorti E. K. si ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK, në vlerën 10.002.316 lekë, në analizën për vitin 2009, në Kolegj janë konsideruar të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit të subjektit, ndryshe nga sa konkluduar nga Komisioni në analizën e vitit 2009, në të cilën nuk janë përfshirë të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit.

122. Për sa i përket vlerës, konstatohet se në analizën e vitit 2009, duhet të përfshihet vlera prej 476.095 lekësh e cila, referuar deklaratës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitin 2009, është vlera e fitimit të vitit 2009, prej 532.782 lekësh, duke zbritur parapagimet prej 48.000 lekësh, si dhe tatimin e detyrueshëm për t’u paguar nga rezultatet e vitit të mëparshëm (2008), prej 8.687 lekësh, që kanë rezultuar sipas deklaratës së datës 31.03.2009, e në përfundim rezulton vlera prej 476.095 lekësh.

123. Lidhur me llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve me destinacion Italinë, në analizën e vitit 2009, sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi TIMS, për të cilat subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk janë marrë në konsideratë deklaratat noteriale të vjehrrës dhe dajës së bashkëshortit, te të cilët ka pretenduar se ka qëndruar subjekti si dhe familjarët, konstatohet:

123.1. *Së pari*, Komisioni si në analizën financiare të vitit 2009 në rezultatet hetimore, ashtu dhe në vendim, ka konsideruar shpenzime udhëtimi sipas TIMS-it, vlerën prej 275.026 lekësh; *së dyti*, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar qëndrimin te vjehrra në Itali, dhe në përgjigje të rezultateve hetimore në Komision, ka bashkëlidhur deklaratën noteriale me nr. rep. {***}, kol. {***}, datë 29.10.2021, të nënës së bashkëshortit, znj. G. K., e cila ka deklaruar se: *djali im E. K., së bashku*

¹⁵ Bashkëlidhur shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore, Durrës nr. {***} prot., datë 11.05.2021.

me nusen e tij, znj. Eda Kaja, dhe fëmijët A.K. dhe M. K., sa herë që kanë ardhur në Itali, kanë qëndruar në banesën time dhe të gjitha shpenzimet gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Itali, janë mbuluar prej meje G. K. (nëna, vjehrra dhe gjyshja e tyre). Ndërsa konstatohet se lidhur me qëndrimin te daja i bashkëshortit I. C., subjekti ka pretenduar për qëndrimin te ky i fundit kryesisht në katër muajt e fundit të vitit 2009, siç është shprehur në përgjigjet e rezultateve hetimore, ashtu dhe në ankimin drejtuar Kolegjit. Për qëndrimin te daja i bashkëshortit, z. I. C., subjekti i rivlerësimit ka depozituar bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, deklaratën noteriale me nr. rep. {***}, kol. {***}, datë 26.08.2021, të z. I. C., në të cilën ai shprehet se: [...] janë akomoduar në shtëpinë time dhe shpenzimet e gjithë kohës së qëndrimit në këtë shtet janë mbuluar me të ardhurat e mia dhe familjes sime, sipas traditës familjare, dhe lidhjes shumë të afërt të gjakut dajë dhe nip; së treti, konstatohet se në paragrafin 1.12 të “Aneksit 1 për metodologjinë e kryerjes së analizës financiare 2003-2016” të rezultateve hetimore, Komisioni është shprehur se: subjekti duhet të depozitojë dokumentacion që të provojë qëndrimin te [...] dhe I. C. [daja i bashkëshortit të subjektit] sepse shpenzimet e qëndrimit janë marrë sipas deklaratimit të subjektit. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve hetimore, ka sjellë në vëmendje të Komisionit deklaratën e z. I. C. (dajës së bashkëshortit) të depozituar bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2. Në vijim, në vendim, Komisioni i ka lënë shpenzimet e udhëtimit për vitin 2009 sipas përllogaritjeve në rezultatet hetimore, duke pranuar dhe u qëndruar përllogaritjeve për qëndrimin te daja i bashkëshortit në Itali, sipas deklarimeve të subjektit.

123.2. Gjithashtu, Komisioni, në përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve, ka marrë në konsideratë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, për qëndrimin te vjehrra e saj në Itali, znj. G. K., duke konkluduar në vendim se: [...] në analizën dërguar me rezultatet e hetimit, ka marrë në konsideratë në llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, faktin e qëndrimit të shtetases G. K..

123.3. Në përfundim, konstatohet se nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se për shpenzimet e udhëtimeve sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi TIMS, në analizën e vitit 2009, me destinacion Italinë, nuk janë marrë në konsideratë në përllogaritjen e shpenzimeve sipas deklaratave noteriale të vjehrrës, tek e cila ka pretenduar se ka qëndruar subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja, dhe familja e saj, pasi Komisioni ka arsyetuar në vendim (paragrafi 17.3.13¹⁶) se e ka konsideruar qëndrimin te vjehrra e saj në llogaritjet e shpenzimeve të udhëtimeve. Gjithashtu, edhe për udhëtimet në Itali te daja i bashkëshortit të saj, z. I. C., Komisioni ka marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit, siç konstatohet në Aneksin e rezultateve hetimore (paragrafi 1.12), ku e njëjta vlerë në analizën financiare të vitit 2009, është përfshirë si në përllogaritjet në rezultatet hetimore, ashtu dhe në analizën financiare të vitit në vendim.

124. Referuar pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për analizën e vitit 2009, se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit dhe për kryerjen e të gjitha shpenzimeve duke rezultuar

¹⁶“17.3.13 Komisioni, në analizën dërguar me rezultatet e hetimit, ka marrë në konsideratë në llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, faktin e qëndrimit të shtetases G. K..”

me bilanc pozitiv 63.987 lekë, konstatohet se: a) duke konsideruar në analizën financiare të vitit të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i bashkëshortit, në shumën 476.095 lekë sipas përlllogaritjeve të Kolegjit; b) duke lënë shpenzimet e udhëtimit sipas përlllogaritjeve të Komisionit, pasi pretendimet e subjektit janë konsideruar në këto përlllogaritje; c) duke mos konsideruar të ardhurat nga shitja e aksioneve në kantinën e pijeve “{***}” prej 100.000 lekësh, konsideruar nga subjekti i rivlerësimit në analizë; d) duke konsideruar si të ardhur nga shitja e automjetit me targë {***}, sipas kontratës së shitjes datë 15.07.2009, shumën prej 1.000.000 lekësh, e duke lënë elementet e tjera të analizës financiare njësoj si ka konsideruar dhe Komisioni, por dhe subjekti i rivlerësimit në analizë, diferenca negative e konkluduar nga Komisioni, prej (-) 616.648 lekësh, është korrigjuar duke rezultuar një balancë pozitive në këtë vit.

• **Lidhur me analizën financiare të vitit 2014:**

125. Subjekti i rivlerësimit pretendon që të ardhurat nga shitja e automjetit me targë {***}, në analizën e vitit 2014 të konsiderohen në vlerën 770.605 lekë dhe jo 280.420 lekë, sipas përlllogaritjes së çmimit të blerjes sipas Komisionit, pasi subjekti ka paguar tatimin për diferencën e çmimit të shitjes me të blerjes në vitin 2021. Lidhur me këtë pretendim, ashtu si dhe është trajtuar e analizuar më sipër në vlerësimin e shkakut të ankimit, u konsiderua si e ardhur vlere e shitjes e automjetit me targë {***}, prej 5.500 eurosh, ose ekuivalenti prej 770.605 lekësh.
126. Lidhur me pretendimin se për *shpenzimet e udhëtimeve*, sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi TIMS, në analizën e vitit 2014, me destinacion Italinë, nuk janë marrë në konsideratë deklaratat noteriale të vjehrrës dhe dajës së bashkëshortit, te të cilët ka pretenduar se ka qëndruar subjekti dhe familja e tij, konstatohet së pari, se Komisioni si në analizën financiare të vitit 2014, në rezultatet hetimore, ashtu dhe në vendim, ka konsideruar shpenzime udhëtimi TIMS vlerën prej 377.130 lekësh; së dyti, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar qëndrimin te vjehrra në Itali dhe në përgjigje të rezultateve hetimore në Komision, ka bashkëlidhur deklaratën noteriale me nr. rep. {***}, kol. {***}, me përmbajtjen e cituar më lart. Ndërsa pretendimi lidhur me qëndrimin te daja i bashkëshortit, z. I. C., konstatohet se nuk lidhet me analizën financiare të vitit 2014, pasi subjekti ka pretenduar për qëndrimin te ky i fundit kryesisht në katër muajt e fundit të vitit 2009, siç është shprehur në përgjigjet e rezultateve hetimore, ashtu dhe në ankim; së treti, Komisioni në vendim është shprehur se: *në analizën dërguar me rezultatet e hetimit, ka marrë në konsideratë në llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, faktin e qëndrimit të shtetas G. K.* Referuar sa më sipër, Kolegji konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi TIMS në analizën e vitit 2014, me destinacion Italinë, nuk qëndron, pasi Komisioni ka arsyetuar në vendim (paragrafi 17.3.13) se e ka konsideruar qëndrimin te vjehrra e saj në llogaritjet e shpenzimeve të udhëtimeve.
127. Referuar analizës sa më sipër, të vitit 2014, ku subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se ka rezultuar me diferencë pozitive (prej + 329.515 lekësh), pra se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit në qershor të vitit 2014, në kushtet kur në të njëjtën periudhë ka shitur automjetin tjetër në të njëjtën vlerë, po kështu dhe për kryerjen e të gjitha shpenzimeve, konstatohet se duke

u konsideruar si e ardhur nga shitja e automjetit me targë {***}, vlera prej 5.500 eurosh, ose 770.605 lekësh, pasi u paguan tatimet gjatë hetimit në Komision, e jo sipas analizës së Komisionit që ka konsideruar si të ardhura vlerën e blerjes prej 280.420 lekësh, diferenca negative e konkluduar nga Komisioni, prej -256.151 lekësh, është korigjuar duke rezultuar një rezultat pozitiv për këtë vit.

128. Në përfundim, referuar shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me analizën financiare të viteve, trajtuar sa më sipër, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme, në vlerën prej (-) 3.819.256 lekësh¹⁷, për të krijuar pasuritë në vite dhe për të përballuar shpenzimet e ndryshme të jetesës.
129. Kolegji konstaton se edhe nëse do të pranoheshin të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e dy pasurive, apartament dhe njësi shërbimi në Durrës dhe të konsideroheshin ato si të ligjshme, pavarësisht mungesës së pagimit të tatimeve, sërish subjekti do të ndodhej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, që vjen për shkak të mosdeklarimit e mosprovimit të pasjes së likuiditeteve *cash* në vitet 2003 e 2007, të cilat janë përdorur si burim për krijimin e pasurive, krahas mungesës së burimeve të ligjshme për vitet e analizës financiare të shqyrtuar më lart, në një nivel që nuk do të kapërcente dot nivelin e besueshëm të pasurisë. Në këtë arsyetim, trupi gjykues mban në konsideratë qëndrimin e Kolegjit se: *[...] të vetmet burime që mund të japin informacion për gjendjen e likuiditeteve cash, janë deklaratat e subjekteve të rivlerësimit në deklaratat e pasurive, aq më tepër kur burimet e krijimit të tyre mbështeten vetëm në deklarime dhe në asnjë akt shkresor që të provojë plotësisht ekzistencën e tyre apo burimin e krijimit të tyre. Në këtë kontekst, deklaratat duhet të jenë bindëse, të qarta, koherente e në harmoni me të dhënat e tjera, në mënyrë që të arrijnë nivelin e duhur të provueshmërisë së kësaj lloji pasurie*¹⁸.
130. Në përfundim, Kolegji, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Eda Kaja, gjendet në kushtet e parashikuara nga nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, situatë e cila, krahas problematikave të tjera të konstatuara në deklaratat në vite të subjektit, ndonëse jo të atashuara në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndonjë nga rastet e nenit 33, pika 5 e të ligjit nr.84/2016, çojnë në përfundimin se subjekti ka dështuar të provojë bindshëm pasuritë e saj në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe gjendet para situatës së parashikuar prej pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili obligon vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për pasojë, vendimi nr.476, datë 16.11.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjendet i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

¹⁷ Si total i rezultateve negative: në vitin 2004, prej -1.746.922 lekësh; në vitin 2005, duke u ulur në -114.384 lekë; në vitin 2008, duke u ulur në -1.957.950 lekë. Vitet 2009 dhe 2014 nga “me balancë negative” rezultuan “me diferencë pozitive”.

¹⁸ Shih vendimin e Kolegjit nr. 26/2022 (JR).

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 476, datë 16.11.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 31.10.2022, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi - kundër

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e relatores së çështjes, votoj kundër mendimit të shumicës së trupit gjykues, shprehur me vendimin nr. 41, datë 31.10.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, (në vijim “Kolegji”), që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 476, datë 16.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, për arsyet si më poshtë.
2. Qëndrimi im në pakicë ka të bëjë me vlerësimin për kriterin e pasurisë. Komisioni ka zhvilluar hetimin administrativ dhe ka konkluduar vetëm për kriterin e pasurisë duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, vendim i cili u la në fuqi edhe nga Kolegji. Për dy kriteret e tjera: kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, rezulton që nuk janë vlerësuar, edhe pse subjekti i rivlerësimit ka kërkuar zyrtarisht dy herë vlerësimin për këto kritere.
3. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ndodhur në dosje, relatimit të çështjes në dhomë këshillimi dhe bisedimeve të zhvilluara, vlerësoj se vendimi i Komisionit për moskualifikimin e subjektit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, i konfirmuar nga vendimi i shumicës së trupit gjykues të Kolegjit, është i gabuar dhe në kundërshtim me rrethanat dhe provat e shqyrtimit të çështjes dhe, si i tillë, duhej të ishte ndryshuar, duke konstatuar se subjekti arrin nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë.
4. Gjatë shqyrtimit tërësor të çështjes, në ndryshim nga konkluzionet e Komisionit dhe të shumicës së trupit gjykues, nuk konstatova asnjë rrethanë të deklaramit të pasurive që përbën deklaramit të rremë, konflikt interesi në krijimin e pasurive dhe burime të ardhurash të pajustificuara dhe të paligjshme. Kam konstatuar vetëm pasaktësi në deklaramet vjetore në lidhje me gjendjen e *cash-it*, të cilat në analizë edhe të provave të tjera të administruara dhe mënyrën e interpretimit të tyre, vlerësoj se nuk arrijnë në nivelin e marrjes së masës të shkarkimit nga detyra.
5. Për sa më lart, në vlerësimin tërësor të çështjes, sipas nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), si dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit, bazuar në bindjen e krijuar, i propozova trupit gjykues të Kolegjit konfirmimin e subjektit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, prishjen e vendimit të Komisionit dhe urdhërimin e tij për të vijuar me procesin e rivlerësimit edhe për dy kriteret e tjera.
6. Për sa i përket kriterit të pasurisë, në analizë të kontrollit të pasurive të krijuara gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarës, të ligjshmërisë së burimeve të krijuarit të këtyre pasurive, të mundësive objektive të subjektit të rivlerësimit për të krijuar këto pasuri, në vlerësimin tim si relatores, ato rezultojnë me burime të ligjshme, të krijuara kryesisht me të ardhura nga trashëgimia, sipas një prej formave klasike të saj, parashikuar nga Kodi Civil, si dhe me të ardhura nga pagat e saj dhe të personit të lidhur (bashkëshortit), gjatë viteve të punës dhe të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit privat të bashkëshortit.

7. Ndaj mendim dhe qëndrim të njëjtë me shumicën e trupit gjykues për arsyetimin dhe konkluzionet e arritura në vendimin e Kolegjit nr. 41, datë 31.10.2022, lidhur me:

7.1. konkluzionin e Komisionit se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë të pasurive, të shprehur në paragrafët 41 e 42 të vendimit;

7.2. shitjen e njësisë së shërbimit me sip. 23,79 m², të shprehur në paragrafët 57.2, 57.3 dhe 58 të vendimit;

7.3. konkluzionin e Komisionit për kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin P. Ll., të shprehur në paragrafin 65 të vendimit;

7.4. kredinë bankare, marrë pranë NBG Bank Durrës, për blerjen e një apartamenti të përbashkët të regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit, të shprehur në paragrafët 70, 71 dhe 72 të vendimit;

7.5. të ardhurat nga shitja e aksioneve të kantinës së pijeve “{***}”, në emrin e subjektit dhe të bashkëshortit, të shprehura në paragrafët 87 dhe 88 të vendimit;

7.6. automjetet në emër të bashkëshortit të subjektit, të shprehura në paragrafët 96 dhe 97 të vendimit;

7.7. të ardhurat në vlerën 10.002.316 lekë, të bashkëshortit të subjektit si ortak i vetëm i shoqërisë “{***}”, të shprehura në paragrafin 103 të vendimit;

7.8. blerjen e automjetit të personit të lidhur, djalit A. K., me burim krijimi të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm, të shprehur në paragrafët 109 dhe 110 të vendimit;

7.9. huatë e marra në shumat 10.000 euro në vitin 2005 dhe 10.000 euro në vitin 2006, nga shtetasi D. H., të shprehura në paragrafët 114.6 dhe 114.7 të vendimit.

8. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk duhej të ishte ngarkuar me përgjegjësi disiplinore në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016 dhe t’i jepej masa e shkarkimit nga detyra, për sa më poshtë.

8.1. Lidhur me të ardhurat nga shitja e një shtëpie në emër të bashkëshortit, vjehrrës dhe kunatit në shumën 4.000.000 lekë, të përdorura për punime dhe arredimin e apartamentit të banimit të vitit 2005:

8.1.1. Shumica e trupit gjykues ka konkluduar se¹⁹: [...] Kolegji e gjen të drejtë qëndrimin e mbajtur prej Komisionit se e ardhur e ligjshme e krijuar nga ky transaksion do të duhet të konsiderohet vetëm shuma prej 2.000.000 lekësh, e cila i është nënshtruar tatimit dhe, si e tillë, do të konsiderohet në analizën financiare që është bërë në drejtim të verifikimit të burimeve të subjektit për të financuar krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të tjera. [...] Në mbështetje të konkluzionit se si e ardhur e ligjshme nga shitja e apartamentit të familjes së bashkëshortit do të konsiderohet vlera prej 2.000.000 lekësh, sipas analizës financiare të vitit 2004, të kryer në Kolegji, konfirmohet

¹⁹ Paragrafët 26, 30, 31 të vendimit të Kolegjit.

rezultati i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë rezultuar më një mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve për këtë vit, në vlerën prej (-)1.746.922 lekësh.

8.1.2. Sa i përket kësaj pasurie, vlerësoj se duhej të konsiderohej e plotë vlera prej 4.000.000 lekësh e shitjes së apartamentit me sip. 78,9 m² në vitin 2004, me kontratën nr. {***}, dt.12/11/2004, në emër të vjehrrës, bashkëshortit dhe kumatit të subjektit të rivlerësimit, sepse nga dokumentacioni në dosje, rezultojnë provuar me transaksion bankar, kalimi i shumës nga shitësi në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit. Ky fakt është pohuar nga subjekti i rivlerësimit në rezultatet hetimore, në parashtrimet në seancë dëgjimore në Komision, në ankime e parashtrime në Kolegj: *Shitja e kësaj pasurie është deklaruar në DPV-në e vitit 2005, në shumën totale prej 4.000.000 lekësh, sipas kontratës së shitblerjes së lidhur më datë 12.11.2004. Të ardhurat nga kjo shitje janë deklaruar dhe në deklaratën “vetting”. Ekzistojnë transaksione bankare që provojnë shitjen e kësaj pasurie. Lidhur me lëvizjen e llogarisë bankare në Intesa San Paolo Bank të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nr. {***}, sjellë bashkëlidhur shkresës që banka i ka dërguar Komisionit nr. {***} prot., datë 20.02.2020, rezultojnë provuar se kjo llogari është kredituar me vlerën 4.200.000 lekë, më 17.11.2004, me përshkrimin: *derdhje fav save {***} K. E. nga save {***} Xh. I. për shitje shtëpie*. Pra, konstatohet dhe qëndron pretendimi i subjektit se “ekzistojnë transaksione bankare që provojnë shitjen e kësaj pasurie”.*

8.1.3. Subjekti nuk duhej të ngarkohej me përgjegjësi dhe të penalizohej maksimalisht duke u konsideruar nga shumica e trupit gjykues vetëm vlera e shitjes së apartamentit në shumën prej 2.000.000 lekësh, si e ardhur e ligjshme, për aq sa rezultojnë që të jetë paguar tatimi për shitjen në vlerën prej 10.000 lekësh. Është e vërtetë që në aktet në fashikullin e Komisionit rezultojnë dy kontrata shitblerjeje për apartamentin: kontrata e paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit, me nr. {***}, datë 12.11.2004, me shitës shtetasit G., A. dhe E. K. dhe blerës shtetasin Xh. I., për shitjen e apartamentit me sip. 78,09 m² ndodhur në lagjen {***}, rruga “{***}”, Durrës, me çmimin 4.000.000 lekë, çmim i paguar jashtë zyrës noteriale, si dhe kontrata e depozituar në ASHK me të njëjtat ekstremite, por me çmimin 2.000.000 lekë, çmim i paguar jashtë zyrës noteriale. Rezultojnë provuar se vetë subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë palë e përfshirë në këtë kontratë shitblerjeje, si dhe është fakt që nuk ka ndjekur dhe nuk është marrë me veprimet noteriale dhe të regjistrimit të pronës e të pagimit të tatimit për shitjen. Këto veprime janë kryer nga vjehrra e subjektit, e cila ka paguar aq sa i është kërkuar në faturë, pra vlerën prej 10.000 lekësh, (mandatarkëtimi nr. {***}, datë 17.11.2004, arkëtuar nga shtetasja G. K., shuma 10.000 lekë, me përshkrimin: “{***}”).

8.1.4. Në këto kushte, kur provohet me dokument bankar, si një veprim i qartë dhe i sigurt, kalimi i shumës prej 4.000.000 lekësh, si çmim i shitjes së apartamentit dhe vlera e papaguar e tatimit për çmimin e plotë të apartamentit është në një shifër shumë e ulët (10.000 lekë), si dhe subjekti i rivlerësimit nuk ishte palë në transaksionet e kryera, çmuj se shumica duhej të mbante në konsideratë aplikimin e parimit të proporcionalitetit duke e konsideruar të plotë vlerën e çmimit të shitjes së apartamentit dhe përfshirjen si të ardhur të ligjshme në analizën financiare për vitin 2004,

si dhe konsiderimin që këto të ardhura janë përdorur për punime dhe arredimin e shtëpisë me sipërfaqe 115,9 m² në Durrës, në vitet 2005 dhe 2006.

8.1.5. Lidhur me qëndrimin e shumicës për sjelljen e subjektit të rivlerësimit për korrigjimin e shkeljes së ligjit në momentin e marrjes dijeni për mospagimin e vlerës së plotë të tatimit për shitjen, ku ndër të tjera parashtrohet se²⁰: *Subjekti rezulton se është sjellë ndryshe me detyrimin tatimor të pretenduar se duhej të paguhej për shkak të shitjeve të automjeteve me çmim më të lartë se blerja, siç do të arsyetohet në vijim, por ka pasur një qasje indiferente në lidhje me këtë pasuri, ndonëse situata e ekzistencës së dy kontratave ka qenë evidente, në parim i bashkohem këtij qëndrimi, por sjell në vëmendje se vlera për të cilat është paguar detyrimi tatimor në rastin e shitjeve të automjeteve, si tatim për kalimin e së drejtës së pronësisë me shitje prej 223.954 lekësh, e përbërë nga 222.291 lekë principal, interes 329 lekë dhe gjobat 1.334 lekë, është ndjeshëm dhe dukshëm shumë më e lartë se vlera prej 10.000 lekësh në rastin e mosveprimit për shlyerjen e detyrimit tatimor për shitjen e apartamentit të vjehrrës, konsideruar si shmangie e detyrimit tatimor. Gjithashtu, vlerësoj se paralelizmi nuk është i plotë, sepse në rastin e shitjes së automjeteve kemi të bëjmë me pasuri të subjektit të rivlerësimit, ndërsa në këtë rast kemi të bëjmë me pasuri të vjehrrës së subjektit të rivlerësimit.*

8.1.6. Për sa më lart, jam shprehur për të mos e rënduar pozitën e subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, me veprime juridike në të cilat nuk ka qenë palë dhe që nuk janë kryer prej saj, si dhe për konsiderimin si të ardhur me burime të ligjshme të shumës prej 4.000.000 lekësh, të vlerës së plotë të apartamentit. Konsiderimi i kësaj shume do ta ulte vlerën e pamjaftueshmërisë në analizën financiare të vitit 2004, nga me vlerë negative prej (-) 1.746.922 lekësh, konkluduar nga Komisioni dhe konfirmuar nga Kolegji, në vit me diferencë pozitive, pra me mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve për këtë vit.

8.2. *Lidhur me vlerën e investuar për pasurinë apartament me sip. 115,9 m², në rrugën “{***}” (ish-rruga “{***}”), Shk. {***}, K. {***}, Ap. {***}, Durrës:*

8.2.1. Shumica e trupit gjykues, në paragrafët 48 dhe 49 të vendimit, është shprehur: *Kolegji në vazhdim të qëndrimit të mbajtur më sipër në këtë vendim, ku ka konsideruar si të ardhur të ligjshme nga shitja e apartamentit në Durrës, në emër të bashkëshortit, vjehrrës dhe kunatit, vlerën 2.000.000 lekë, konkludon se është i bazuar vlerësimi i Komisionit se për pasurinë apartament me sip.115,9 m², në Durrës, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, në shumën 473.000 lekë, për pagesën lidhur me investimet e kryera për mobilimin dhe punimet për këtë pasuri në vitin 2006, prej 20.000 eurosh, ose e konvertuar në 2.473.000 lekë. Kolegji mori në shqyrtim edhe konkluzionin tjetër të Komisionit që lidhet me deklarin e pasaktë të vlerës së investimit për këtë pasuri në deklaratën “vetting” dhe ato periodike, dhe i rezultoi se ky konkluzion është i drejtë. Nga analizimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, në deklaratat periodike në vite, rezulton se pas deklarimit që ajo ka bërë në vitin 2005, se i detyrohet shoqërisë ndërtimore, në vlerën prej 27.000 eurosh, për përfitimin e pasurisë apartament, vlerë e cila sipas po këtij deklarimi, do të shlyhej brenda vitit 2006, nuk ka më gjurmë të deklarimeve në vite rreth kryerjes së këtij shpenzimi. Nga hetimi i Komisionit, ka rezultuar se*

²⁰ Paragrafi 26 i këtij vendimi.

subjekti nëpërmjet një transferte bankare, ka bërë një pagesë të këtij detyrimi në vlerën prej 20.000 eurosh, të përshkruar më sipër në vitin 2006, por e padëklaruar në DIPP-në e vitit 2006, në kundërshtim me detyrimet ligjore që i buronin nga ligji nr. 9049/2003 për deklarimin e shlyerjes së detyrimeve financiare në vitin korrent. Ndërsa ka rezultuar kjo situatë, nga aktet bankare të administruara gjatë hetimit dhe të pranuar edhe prej vetë subjektit, në deklaratën “vetting” subjekti deklaroi se vlera e paguar prej saj si shpenzim për fitimin e pasurisë apartament, përtej kontratës së shkëmbimit, është vetëm 10.000 euro, vlerë e cila siç ka rezultuar nga hetimi, është paguar prej subjektit që në vitin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes dhe deklaruar prej saj si e paguar që në DIPP-në e vitit 2005. Në këto kushte, pavarësisht mosdakordësisë me qëndrimin e Komisionit se deklarimet e pasakta të subjektit në deklaratat periodike përbëjnë një shkak për ta kualifikuar atë nën parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, deklarimi i paplotë dhe i pasaktë i vlerës së investimit për këtë pasuri në deklaratën “vetting”, plotëson kondicionin ligjor për të qenë nën parashikimin e këtij neni. Për këto shkaqe, Kolegji e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit për këtë pjesë.

8.2.2. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se edhe pse konstatohet ndonjë pasaksësi në deklaratat periodike sa i përket mosdeklarimit të veprimeve të kryera me bankë për vlerën e investuar në apartamentin me sip. 115,9 m², ku subjekti i rivlerësimit ka banuar në vazhdimësi nga viti 2005, vlen të nënvizoj se subjekti i rivlerësimit, të gjitha veprimet me firmën e ndërtimit “{***}” ShPK, i ka kryer me transaksione bankare dhe i ka qartësisht të provuara, çka i bën lehtësisht të provueshme dhe të gjurmueshme edhe pagesat lidhur me investimet e kryera për mobilimin dhe punimet për këtë pasuri: në vitin 2005 prej 10.000 eurosh, dhe në vitin 2006 prej 20.000 eurosh. Këto pagesa evidentohen në vitin 2005, pas lëvritimit të kredisë marrë në NBG Bank më datë 23.12.2005, në vlerën 10.000 euro, sipas lëvizjeve bankare dhe transfertave të datës 27.12.2005, dhe në vitin 2006 sipas lëvizjeve të llogarisë në Pro Credit Bank, me transfertën e datës 05.06.2006, me përshkrim: nga E.Kaja per P.Ll. kësti shtëpi.

8.2.3. Për sa më lart, e konsideroj të padrejtë qëndrimin e Komisionit se deklarimet e pasakta të subjektit në deklaratat periodike përbëjnë një shkak për ta kualifikuar atë nën parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, pasaktësi që çon në marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, qëndrim i cili është konfirmuar nga shumica e trupit gjykues.

8.3. Lidhur me pasurinë apartament, regjistruar në emër të bashkëshortit, me sipërfaqe 55 m², me adresë: Ap.{***}, K. {***}, L. {***}, {***}, Durrës, burim krijimi të ardhurat familjare dhe kredi në NBG Bank:

8.3.1. Jam shprehur kundër mendimit të shumicës së trupit gjykues që ka vendosur të mos konsiderojë në analizën financiare të vitit 2008, shumën prej 1.000.000 lekësh, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si gjendje *cash* e krijuar në vitin 2003 dhe që është përdorur në vitin 2008 si burim i ligjshëm për punimet në apartamentin me sipërfaqe 55 m², me adresë: Ap. {***}, K. {***}, L. {***}, {***}, Durrës, edhe pse nga deklaratat periodike vjetore rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditete *cash*, si në deklaratën fillestare të deklarimit të pasurisë në vitin 2003, ashtu dhe në deklaratat periodike për vitet 2004 – 2016.

8.3.2. Nga analiza financiare e kryer në vendim nga Komisioni për periudhën “para vitit 2003”, ka rezultuar se subjekti kishte mundësi kursimi deri në vlerën +2.541.515 lekë, e cila më tej është konsideruar e përdorur në analizën e vitit 2003 (pasi pasuritë e deklaruara: automjeti i blerë në vitin 2003 prej 500.000 lekësh dhe likuiditetet te Fefad Bank prej 280.000 lekësh kishin burim të ardhurat në vite), duke rezultuar me diferencë pozitive +2.009.668 lekë. Pra, referuar analizës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kursente vlerën që pretendon, prej 1.000.000 lekësh, si kursime *cash*, por të padeklaruara.

8.3.3. Mosdeklarimin e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2003, e konsideroj si pasaktësi nga subjekti i rivlerësimit në deklaram, për sa kohë është provuar si në Komision, edhe në Kolegj që subjekti kishte mundësi të kursente deri në fund të këtij viti vlerën e pretenduar prej 1.000.000 lekësh. Pra, referuar analizës financiare, subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi të kursejnë në fund të vitit 2003, vlerën e pretenduar si kursime *cash*, prej 1.000.000 lekësh, të mbajtur *cash* dhe të përdorur në vitin 2008.

8.3.4. Edhe pse tashmë Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar për pranimin e ekzistencës së likuiditeteve *cash*²¹, ku si provë e domosdoshme konsiderohet deklarata periodike vjetore, unë si anëtare e Kolegjit, i qëndroj mendimit që vlerësimi dhe interpretimi duhet bërë rast pas rasti edhe për mundësinë e krijimit të një *cash*-i të ligjshëm, por të padekluar nga shkaqe që kanë ose jo një peshë të caktuar në analizën financiare, si dhe në historikun e detyrimit për deklaram të pasurive dhe interesave financiarë të subjekteve të rivlerësimit. Konkretisht, për subjektin e rivlerësimit, znj. Eda Kaja, më rezulton se:

- deklarimi i vitit 2003 është deklarim për herë të parë i subjektit në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, dhe mund të pranohen edhe moskuptime apo pasaktësi në zbatimin e tij;
- subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kishin vite që ishin në marrëdhënie pune me mundësinë për të krijuar kursime;
- Komisioni dhe Kolegji në fund të vitit 2003, konstatojnë mundësinë për kursime të ligjshme në shumën e pretenduar, prej 1.000.000 lekësh;
- Komisioni dhe Kolegji, *a priori* shprehen se kursimi i ligjshëm i krijuar deri në vitin 2003, është shpenzuar brenda vitit 2003, por pa provuar se si është shpenzuar kjo shumë e madhe brenda vitit, duke mos faktuar asnjë shpenzim të dukshëm të kësaj natyre në analizën e vitit 2003 nga ana e subjektit;
- likuiditeti *cash*, i padekluar në deklaratën periodike, por i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së në procesverbalin e datës 20.10.2010, dukshëm përpara fillimit procesit të rivlerësimit, i cili në pyetjen 2, ka sqaruar pasaktësinë në mosdeklarimin e *cash*-it, të përdorur gjatë vitit 2008;
- nëse do të ecej me interpretim, në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit, lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 55 m², {***}, Durrës, është

²¹ Vendim nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019, paragrafi 43; vendim nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, paragrafi 32.5; vendim nr. 29/2019 (JR), datë 08.11.2019, paragrafi 31; vendim nr. 1/2020 (JR), datë 15.01.2020, paragrafi 50; vendim nr. 11/2019 (JR), paragrafi 27; vendim nr. 27/2020 (JR), paragrafi 19.4.

shprehur: *burimi i krijimit: të ardhurat familjare dhe kredia në NBG*. Pra, të ardhurat familjare kuptohen dhe si *kursime familjare*, apo likuiditet *cash*, si terminologji e përdorur për *kursimet cash*, e hasur edhe në deklarime të subjekteve të tjera të rivlerësimit.

8.3.5. Në rastin konkret, çmuj se pavarësisht mosdeklarimit të gjendjes *cash*, ka rezultuar se për çdo pasuri të krijuar nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, burimi financiar ka qenë i ligjshëm, i rrjedhur nga të ardhurat nga puna, biznesi apo veprime të tjera juridike të ligjshme. Në këto rrethana, nuk mund të bëhet *zero* kjo vlerë vetëm se nuk është deklaruar në deklaratat vjetore, sikurse argumenton shumica, edhe pse rezultoi e provuar mundësia e krijimit të saj nga Komisioni dhe Kolegji.

8.3.6. Referuar arsytimit të shumicës për gjendjen *cash* dhe deklarimin në deklaratat periodike vjetore si mënyrë e vetme e provimit të ekzistencës së tij, ndaj mendim të kundërt, pasi jo domosdoshmërisht mosdeklarimi i *cash*-it provon mosekzistencën e tij. Duke analizuar gjendjen financiare të subjektit ndër vite, rezultojnë shuma të ardhurash të pashpenzuara gjatë vitit të krijimit. Pavarësisht mosdeklarimit të tyre, provohet se ato kanë ekzistuar dhe janë të ardhura të krijuara me burime të ligjshme e, në këto rrethana, duhet të ishin marrë parasysh nga shumica në analizën financiare të subjektit.

8.3.7. Procesi i rivlerësimit të subjektit sipas Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, është kompleks dhe përfshin në analizë rrethana e fakte të shumta që lidhen me të dhe, për pasojë, edhe në rastin e *cash*-it, nuk mund të mbetet vetëm një vlerësim mekanik dhe i ngurtë i deklaratave vjetore të pasurisë, të cilat përbëjnë vetëm një provë në këtë proces, pa asnjë vlerë të shtuar në krahasim me provat e tjera të administruara.

8.3.8. Në kuptim të ligjit nr. 84/2016, të nenit 3, pika 19, të ardhurat e subjektit të krijuara prej tij dhe familjes, për gjithë periudhën e rivlerësimit, janë të gjitha të krijuara me burime të ligjshme e si të tilla përbëjnë bazë të plotë e të saktë për t'u vlerësuar pozitivisht në kriterin e pasurisë. Baza e vlerësimit të subjektit, sipas nenit 30 e vijues të ligjit, është deklarata e pasurisë *vetting*, e dorëzuar me nisjen e procesit të rivlerësimit. Duke analizuar këtë deklaratë, rezultoi se subjekti ka kryer deklarim të saktë, nuk ka mungesë burimesh financiare për krijimin e pasurisë dhe nuk ka kryer fshehje apo deklarim të rremë të saj.

8.3.9. Mosdeklarimi i gjendjes *cash* nga subjekti në deklaratat vjetore, nuk e ngarkon atë me përgjegjësi të tillë sa të sjellë shkarkimin nga detyra. Do të ishte në kundërshtim me qëllimin e ligjit dhe parimet e këtij procesi rivlerësimi një qëndrim i tillë, për më tepër kur neni 61 i ligjit ka përcaktuar qartë rastet e shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, dhe pasaktësitë në deklarim të subjektit dhe mangësitë në deklaratat vjetore nuk përcaktohen si shkaqe në këtë dispozitë.

8.3.10. Për sa më lart, vlerësoj se shuma *cash* e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, prej 1.000.000 lekësh, si gjendje e vitit 2003 (pranuar edhe nga Komisioni e Kolegji në analizë financiare si shumë që mund të kursehej nga subjekti dhe personi i lidhur), duhej të ishte konsideruar nga shumica e

trupit gjykues si shumë e përdorur në vitin 2008. Konsiderimi i kësaj shume do ta ulte vlerën e pamjaftueshmërisë në analizën financiare të vitit 2008, në shifrën prej (-) 957.950 lekësh, dukshëm më e ulët nga ajo e konkluduar nga Kolegji, në vlerën prej (-) 1.957.950 lekësh.

9. Në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit në Kolegj, shprehur në vendim, rezultojnë që pamjaftueshmëria financiare është në vlerën (-) 3.819.256 lekë²². Kjo pamjaftueshmëri do të reduktohej në vlerën prej (-)1.072.334 lekë²³, duke konsideruar të plotë vlerën e shitjes së apartamentit të vjehrrës prej 4.000.000 lekësh, trajtuar në paragrafët 8.1 – 8.1.6 të këtij mendimi pakice, si dhe konsiderimin e gjendjes *cash* prej 1.000.000 lekësh, deklaruar të përdorur në vitin 2008, trajtuar në paragrafët 8.3 – 8.3.10 të këtij mendimi pakice.
10. Vlerësoj se shumica e trupit gjykues duhet të kishte aplikuar parimet e objektivitetit dhe të proporcionalitetit për kriterin e pasurisë, mbështetur në jurisprudencën e krijuar të Kolegjit²⁴, dhe se rëndesa e shkeljeve të konstatuara nuk mund të çojë në aplikimin e nenit 61, pika 3, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016 vetëm për shkak të problematikave të konstatuara në deklaratimet në vite të subjektit, të cilat, sikurse e pranon edhe shumica e trupit gjykues²⁵, nuk e vendosin atë në mënyrë të drejtpërdrejtë në ndonjë nga rastet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
11. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, konkludoj se vendimi i Komisionit nr. 476, datë 16.11.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Eda Kaja, duhet të priset, duke u konfirmuar subjekti vetëm për kriterin e pasurisë dhe duke u kthyer në Komision për vlerësimin edhe të dy kritereve të tjera, të kontrollit të pasurisë dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

²² Paragrafi 129 i këtij vendimi.

²³ Kjo si rezultat i analizës së vitit 2004, nga sa rezultuar nga shumica me diferencë (-) 1.746.922 lekë në një vit me rezultat pozitiv dhe reduktimi i diferencës negative të vitit 2008 nga (-) 1.957.950 lekë në (-) 957.950 lekë.

²⁴ Vendimet e Kolegjit nr. 14/2020; nr. 18/2021; nr. 26/2021; nr. 17/2022; nr. 19/2022.

²⁵ Paragrafi 131 i këtij vendimi.